



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 502 Akti

Nr. 633 Vendimi
Tiranë, më 9.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Brunilda Bektashi	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 8.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Gentiana Muçaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 19.6.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Gentiana Muçaj, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar¹ mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 17.2.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gentiana Muçaj për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 2.3.2023 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 20.2.2023 subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Në datën 2.3.2023 subjekti dërgoi në rrugë zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ. Në datën 6.3.2023 Komisioni njoftoi subjektin për dërgimin e shpjegimeve në lidhje me konstatimet lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve, pasqyruar në faqen 49 të rezultateve të hetimit, për të cilat po në të njëjtën datë subjekti dërgoi parashtrimet shtesë.

8. Trupi gjykues, në datën 3.3.2023, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Gentiana Muçaj në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 3.3.2023 subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 8.3.2023, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

¹Referohuni rideklarimit të subjektit, datë 20.10.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Gentiana Muçaj u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentiana Muçaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 8.3.2023, për të rifilluar më 9.3.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Gentiana Muçaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kërësive IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gentiana Muçaj, me nr. *** prot., datë 27.2.2018, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005,

²Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më parë subjekti në datën 24.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Banesë me hapësirë me sip. 108.75 m², blerë në datën 28.12.2009, në bashkëpronësi me shtetasin S.M, babai i bashkëshortit të subjektit. Bashkëshorti i deklaruases, z. A.M, ka paguar 3.500.000 lekë kredi nga BKT-ja. Vlera: 79.387 euro. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

³Kontratë sipërmarrjeje (për ndërtim apartamenti) nr. ***, datë 28.12.2009, me palë sipërmarrëse shoqëria “AD***” sh.p.k. dhe palë porositëse A.M dhe S.M, të apartamentit me sipërfaqe totale 108.75 m², me adresë rruga “****”, Tiranë, me vlerë 79.387 euro. Pagesa në shumën 50.000 euro është kryer në momentin e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë i pagesës në shumën 25.000 euro do të paguhet në datën 25.1.2010 dhe kësti i fundit prej 4.387 euro do të paguhet në momentin që porositësi do të marrë dokumentin e pronësisë; vendim nr. ***, datë 29.7.2005, nga KRRT-ja, planimetria e katit, planimetria e apartamentit; deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.4.2008, me deklaruues S.M dhe I.S, në lidhje me apartamentin me sip. 66.68 m², të ndodhur në katin e dytë të një pallati 7-katësh, afër ***, Tiranë, i cili është shitur në vlerën 55.000 euro; nxjerrje llogarie bankare nga BKT, datë 14.10.2016, në emër të shtetasit S.M, derdhje *cash* në vlerën 55.000 euro, datë 16.4.2008, nga shtetasi I.S, me përshkrimin “derdhje për S.M blerje apartamenti”; mandatarkëtim nr. 84, datë 1.2.2001, nga shoqëria “E***” sh.p.k., ku shtetasi S.M ka arkëtuar shumën 21.000 USD, pagesë për apartamentin 1+1; mandatarkëtim nr. ***, datë 22.9.2001, nga shoqëria “E***” sh.p.k., ku shtetasi S.M ka arkëtuar shumën 1.386 USD, likuidim total për apartamentin; dokument datë 14.12.2009, nga “Tirana Bank”, ku citohet se në këtë datë është depozituar shuma 50.000 euro nga shtetasi S.M, me përshkrimin “lik. 2 këste apartamenti”; kontratë kredie bankare nr. ***, datë 30.1.2010, me BKT-në, kredimarrës A.M dhe dorëzuanës Gentiana Muçaj, S.M dhe E.M, në shumën 3.500.000 lekë. Aneks i çeljes dhe përdorimit të kredisë, qëllimi i kredisë është për blerje apartamenti (shihni aneksin nr. 4/2 dhe nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: (a) *përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga BKT-ja, ZVRPP-ja Fier dhe ISSH-ja; (b) ZVRPP-ja Tiranë nuk e konfirmon apartamentin e deklaruar, pasi është me kontratë sipërmarrjeje.*

Hetimi i Komisionit

17.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, me përshkrimin “Porositur me kontratë sipërmarrjeje një banesë 108.75 m² në rrugën ‘***’, Tiranë, apartamenti 2, seksioni E (tri dhoma gjumi, një soxhorno) nga shoqëria ‘***’, me vlerë 79.387 euro. Banesa është në bashkëpronësi me vjehrrin S.M, i cili ka paguar shumën 50.000 euro, ndërsa pjesën prej 25.000 euro me kredi nga A.M. Janë pa likuiduar 4.387 firmës pasi të bëhet kontrata e shitjes”.

17.3 Nga korrespondenca e Komisionit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës nuk konfirmohet regjistrimi i kësaj pasurie.

17.4 Subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e sipërmarrjes⁴ nr. ***, datë 28.12.2009, ku rezulton se bashkëshorti i saj A.M dhe babai i tij S.M kanë kërkuar të blejnë tek sipërmarrësi A.Ç apartamentin me sip. 108.75 m², i ndodhur në katin e pestë, sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 28.7.2005, miratuar nga KRT-ja Tiranë.

17.4.1 Sipas kësaj kontrate rezulton se porositësi ka paguar në favor të shoqërisë në datën e nënshkrimit të kontratës shumën 50.000 euro dhe kësti i dytë 25.000 euro thuhet se do të likuidohet në datën 25.1.2010. Ndërsa, lidhur me këstin e fundit për këtë pasuri në vlerën 4.387 euro, po në këtë kontratë parashikohej se do të paguhet me marrjen e dokumentit të pronësisë së apartamentit.

17.5 Nisur nga fakti që ASHK-ja nuk e konfirmonte këtë pasuri, Komisioni i ka kërkuar⁵ subjektit të rivlerësimit të depozitonte kontratën e shitjes së pasurisë dhe njëkohësisht të qartësonte statusin juridik të pasurisë objekt hetimi administrativ. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se: “...aktualisht nuk disponojmë kontratë shitjeje për shkak se pallati është i paregjistruar në Zyrën e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Për pasojë edhe apartamenti i porositur nga bashkëshorti dhe vjehrrin rezulton i paregjistruar në Zyrën e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Bashkëshorti im A.M është bashkëpronar me vjehrrin në pjesë 27%. Me anë të aplikimit nr. ***, datë 29.5.2019, është aplikuar nga vjehrrin, bashkëshorti dhe më shumë se gjysma e banorëve të pallatit pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug për legalizimin e apartamentit të porositur me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 28.12.2009”.

17.5.1 Subjekti, në mbështetje të deklaratimit, ka depozituar dokumentacionin: (i) kontratë sipërmarrjeje noteriale nr. ***, datë 28.12.2009; si dhe (ii) aplikimin nr. 1042, datë 29.5.2019, kryer pranë Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Jug, e shoqëruar gjithashtu me kërkesën e banorëve të pallatit për legalizim të objektit, ku identifikohen si aplikues bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe babai i tij, z. S.M.

17.5.2 FSHU-ja⁶ nuk konfirmoi abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit, familjarëve të saj dhe bashkëshortit, përveçse një kontratë furnizimi me nr. ***, në instancën Sarandë.

⁴Shihni dokumentin e depozituar nga subjekti në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. 4/2.

⁵Me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

17.5.3 UKT-ja⁷ nuk konfirmoi kontrata të shërbimit me ujësjellës - kanalizime në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj.

- Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

17.6 Në lidhje me shumën 50.000 euro, nga hetimi administrativ rezultoi si vijon:

17.6.1 Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* rezultoi se në rubrikën “të dhëna konfidenciale” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar veprimet e kryera nga babai i bashkëshortit të saj për burimin e krijimit të kësaj pasurie, si vijon: *“Bashkëpronar në apartamentin prej 108.75 m², blerë në shumën 79.387 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 28.12.2009, paguar 50.000 euro. Burimi, shitur banesë 1+1, sipërfaqe 66.68 m², me çmimin 55.000 euro, datë 18.4.2008, shtetasit I.S me deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.4.2008. Paratë depozituar në BKT në emër S.M në datën 16.4.2008. Ky apartament blerë nga ‘E***’ sh.p.k. në vitin 2001 pa kontratë, në shumën 22.386 USD, provuar me mandatin nr. ***, datë 1.2.2001 dhe mandatin nr. ***, datë 22.9.2001. Paguar nga S.M, administratorit të shoqërisë ‘***’, A.Ç me mandatpagesën datë 14.12.2009, në ‘Tirana Bank’, në vlerën 50.000 euro”*.

17.6.2 Meqenëse ky apartament është blerë në bashkëpronësi, Komisioni hetoi për pjesën takuese prej 63% të babait të bashkëshortit, pra për burimin e ligjshëm të shumës 50.000 euro.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burim krijimi për pjesën takuese të vjehrrit prej 50.000 euro kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament në vitin 2008 nga ky i fundit në shumën 55.000 euro.

17.6.3 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit rezultoi se shitja e kësaj pasurie konfirmohet sipas deklaratës noteriale⁸ nr. ***, datë 18.4.2008, ku babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. S.M, i ka shitur shtetasit I.S apartamentin në katin e dytë, me sip. 66.68 m², të ndodhur në adresën rruga “****”, pallati 8, pranë ***, Tiranë, në shumën 55.000 euro, për të cilën palët reciprokisht shtetasit Muçaj dhe S kanë deklaruar se janë likuiduar.

17.6.4 Sipas *statement*-it bankar të BKT-së rezulton se shtetasi I.S në datën 16.4.2008 ka derdhur në llogarinë bankare të shtetasit S.M shumën 55.000 euro, me përshkrimin “blerje apartamenti”, shumë të cilën vjehrrit i subjektit, z. S.M, e ka tërhequr në datën 2.5.2008. Më tej, sipas deklaratës të subjektit të rivlerësimit, shtetasi S.M pas shitjes së kësaj pasurie ka depozituar *cash* në favor të shtetasit A.Ç shumën 50.000 euro, me mandatarkëtimin bankar datë 14.12.2009, në “Tirana Bank”⁹.

17.6.5 Komisioni e ka pyetur¹⁰ subjektin në lidhje me historikun e kësaj pasurie, pra lidhur me origjinën dhe regjistrimin hipotekor të saj, e cila sipas deklaratës të subjektit të rivlerësimit është shitur pa kontratë.

17.6.6 Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka deklaruar: *“...për këtë apartament nuk është lidhur kontratë sipërmarrjeje nga ana e vjehrrit tim, nuk është lidhur as kontrata e shitjes me shoqërinë ndërtuese dhe, për pasojë, nuk ka qenë e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë... Të ardhurat kryesore për blerjen e këtij apartamenti kanë qenë shpërblimet e përfituara nga bashkëshorti im A.M, si punonjës i Policisë së Shtetit, në ***. Urdhrat e Ministrit të Rendit Publik për shpërblimin e punonjësve të cilat kanë qenë të angazhuar në kapjen e mallrave kontrabandë kanë qenë ‘Sekret’, për të mos identifikuar përfituesit e shpërblimeve nga shitja e mallrave të konfiskuara. Nga ana e bashkëshortit tim A.M iu kërkua vjehrrit që të mos lidhej kontratë shitjeje ose sipërmarrjeje me shoqërinë ‘***’*

⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸Shihni dokumentin e depozituar (noterizuar nga noteri publik M.B) nga subjekti në dosjen e ILDKPKI-së, aneks 4/2.

⁹Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰Me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022.

sh.p.k., për arsye sigurie të jetës së tij, si dhe të familjarëve të tij. Për blerjen e kësaj pasurie vjeherri ka dy mandatpagesa pranë shoqërisë ndërtuese ‘***’ sh.p.k., me anë të së cilave ka shlyer të gjithë detyrimin që kishte për apartamentin me sipërfaqe 1+1, me sip. 66.68 m², në shumën 22.386 dollarë. Në kohën që rreziku për jetën ose shëndetin ishte zvogëluar me kalimin e viteve dhe me emërimin e bashkëshortit tim si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, nga ana e vjeherit tim i është kërkuar ndërtuesit të nënshkruajë kontratën e shitjes. Nga informacioni i kohës rezultonte që ndërtuesi kishte dalë jashtë lejes së ndërtimit dhe, për këtë arsye, në fund të vitit 2002 është bërë bllokimi i pallatit të ndërtuar nga shoqëria ‘E***’ sh.p.k. në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Ky bllokim ka vazhduar deri në vitin 2008, kohë në cilin është realizuar edhe shitja e këtij apartamenti nëpërmjet deklaratës noteriale tek shtetasi I.S. Subjekti ka sqaruar se ky apartament nga viti 2001 deri në vitin 2008 ka qenë i paregjistruar në pronësi 100% të vjeherit S. N. M”.

17.6.7 Subjekti ka depozituar si dokumente justifikuese: (i) certifikatën e martesës së A.M me Gentiana Muçaj nr. ***; (ii) mandatpagesën nr. ***, datë 1.2.2001, pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për apartamentin 1+1”, paguar nga shtetasi S.M shuma 21.000 USD dhe nr. ***, datë 22.9.2001, me përshkrimin “likuidim total i apartamentit” në shumën 1.386 USD; (iii) fotokopje të librezës së pagesës së energjisë elektrike pranë KESH-it, me nr. kontrate ***, në emër të shtetasit S.M; (iv) faturën e pagesës së energjisë elektrike të muajit mars 2008 për kontratën nr. *** në emër të shtetasit S.M, me adresë ***, ***, 3, 2 dhe njëkohësisht ka dhënë sqarime lidhur me provueshmërinë e ekzistencës së apartamentit nga ana e saj dhe familjes, duke iu referuar pikërisht faturimeve/pagesave, adresës së shënuar në librezën e energjisë elektrike, etj.

17.6.8 Lidhur me statusin juridik aktual të kësaj pasurie, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se ky apartament tashmë është regjistruar në emër të shtetasit I.H.S pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, me certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar në datën 25.3.2015, për pasurinë me sip. 66.68 m², nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: rruga “****”, hyrja 2, apartamenti nr. ***. Subjekti ka depozituar¹¹ si dokumente justifikuese: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.4.2008, së bashku me planimetrinë e apartamentit të përbërë nga një dhomë e një kuzhinë (1+1); (ii) certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 23.3.2015, për pasurinë me sip. 66.68 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë rruga “****”, hyrja 2, apartamenti nr. ***; (iii) librezën aktuale të pagesës së energjisë elektrike me nr. kontrate ***, në emër të shtetasit I.S, me adresë rruga “****”, pallati ***, apartamenti nr. ***.

17.6.9 Komisioni gjithashtu e ka pyetur¹² subjektin nëse është paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie nga babai i bashkëshortit dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues për të provuar pagesën dhe vlerën e këtij tatimi. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se: “Për shitjen e kësaj pasurie është llogaritur tatimi mbi të ardhurat nga shitja e banesës me urdhërpagesë ***, Tatimi mbi të Ardhurat Individuale, i datës 26.1.2023, në emër të S.M”. Nga seksioni “Të dhënat për llogaritjen e tatimit”, në pikën 7 “Fitime kapitale nga shitja e pasurisë të paluajtshme në pronësi të deklaruesit”, rezulton diferenca blerje-shitje në shumën 3.573.931 lekë.

17.6.10 Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se tatimin përkatës mbi të ardhurat e përfituara shtetasi S.M e ka paguar nga llogaria e tij në BKT, datë 31.1.2023, me përshkrimin “Tatim mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2021”.

17.6.11 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala, konstatoi se ky apartament rezultoi të jetë blerë nga vjeherri i subjektit të rivlerësimit në një kohë që subjekti nuk ishte anëtare e familjes Muçaj dhe njëkohësisht nuk ishte as në detyrë, pasi nga aktet e administruara rezultoi se

¹¹Me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²Pyetësor datë 23.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

subjekti ka filluar stazhin profesional në tetor të vitit 2001 dhe është martuar në korrik të vitit 2001. Ndërkohë, pothuajse e gjithë vlera e apartamentit është likuiduar në shkurt të vitit 2001 dhe vetëm 1.386 USD janë paguar në shtator 2001. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se: (i) për këtë pasuri nuk është nënshkruar kontratë as për blerjen nga ana e shtetasit S.M në vitin 2001 dhe as për shitjen të shtetasi I.S në vitin 2008; (ii) pasuria është regjistruar në vitin 2015 në emër të shtetasit I.S; (iii) pagesa e tatimit për të ardhurat e përfituara është paguar në vitin 2023.

17.6.12 Bazuar në faktet e parashtruara më sipër, Komisioni konstatoi se nuk evidentohen problematika apo dyshime lidhur me krijimin e këtij burimi, për sa kohë provohet se këto të ardhura vijnë nga shitja e një pasurie tjetër.

17.6.13 Komisioni¹³ për këtë pasuri, në rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit: (i) të jepte shpjegime shteruese lidhur me kalimin e pronësisë së apartamentit tek shtetasi I.S, në raport me faktin që shtetasi S.M nuk ishte/nuk u bë titullar i pronësisë, si dhe lidhur me mospagimin e tatimit në kohën e shitjes së pasurisë, duke depozituar dokumentacion mbështetës; dhe (ii) të depozitonte kontratën e furnizimit me energji elektrike dhe të shërbimit me ujësjellës - kanalizime.

17.6.14 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, në lidhje me kalimin e pronësisë tek shtetasi I.S, ndërkohë që vjehri i saj S.M nuk ishte bërë titullar i pronësisë, ka deklaruar:

- i) vjehri fillimisht ka pasur arsyet e mosnënshkrimit të një kontrate me shitësin e pasurisë për shkak të punësimit të bashkëshortit të saj në Forcat e Rendit, pra për shkak të detyrës së tij nën urdhra sekrete të punëdhënësit;
- ii) provohet që pasuria e cila është shitur është blerë nga vjehri me mandatet përkatëse të arkëtimit, lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., për pagesën e plotë të vlerës së apartamentit;
- iii) provohet kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe kontrata e furnizimit me ujë të pijshëm, të cilat më pas, me të njëjtin numër kontrate, janë transferuar tek shtetasi I.S;
- iv) në tërësi provohet origjina e fitimit të pasurisë;
- v) provohet që palët shitës - blerës kanë nënshkruar deklaratë noteriale për këtë shitblerje në vitin 2008, pra kanë njohur njëra-tjetrën reciprokisht në pozicionet e tyre, pa pasur kontestime;
- vi) provohet kalimi i shumës së shitjes së apartamentit nga z. S tek vjehri me bankë;
- vii) në tërësi provohet se pasuria ka qenë *de facto* e vjehrit dhe, si e tillë, edhe kalimi i saj tek z. S është legjitimuar pa kundërshtime, pasi rezultoi e provuar që është regjistruar në emër të këtij të fundit.

17.6.15 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të depozituar, konstatoi se nga hetimi identifikohen fakte që dëshmojnë për veprime të ndërsjella palëve, duke u sjellë secila prej tyre në tagrin reciprok shitës dhe blerës, pra ku shitësi i pasurisë është pranuar nga blerësi si pronar i saj dhe, si i tillë, është zhveshur nga pronësia, pa pasur mes tyre ndonjë kundërshti, pasi përgjatë hetimit u provua që kjo pasuri është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të blerësit në vitin 2015.

Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk vëren problematika dhe as ngre dyshime lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie dhe titullarin e saj. Po ashtu, në kushtet e konstatimit se subjekti nuk rezultoi e përfshirë në këtë marrëdhënie, i çmon bindëse shpjegimet e saj.

17.6.16 Lidhur me mospagimin e tatimit në kohën e shitjes së pasurisë, subjekti ka deklaruar se ka komunikuar me vjehrin e saj dhe për këtë ka konfirmuar se: (i) vjehri i ka shpjeguar që nuk ka qenë i qartë lidhur me detyrimin tatimor, pasi nuk ka pasur një kontratë, qoftë edhe

¹³Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

sipërmarrjeje në atë kohë; (ii) subjekti ka referuar dy vendime të Komisionit, përkatësisht nr. 56/2018 dhe nr. 311/2020, të formës së prerë, për të cilët ka sqaruar se pasi është konsultuar dhe ka mësuar se është pranuar detyrimi tatimor i paguar me vonesë, atëherë është paguar edhe në këtë rast tatimi nga vjehtëri i saj; (iii) vonesa në pagimin e tatimit mbi fitimin ka ardhur për shkak të bllokimit të veprimeve mbi pallatin në të cilin ndodhej ky apartament, bllokim i cili ka vazhduar jo vetëm në vitin 2008, kur ky apartament është shitur, por edhe në vitet e mëpasshme; (iv) ky bllokim ka sjellë si pasojë mosrealizimin e kontratës së shitjes dhe mos regjistrimin e kësaj pasurie pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë; (v) mospasja e certifikatës së pronësisë ka krijuar paqartësi tek vjehtëri për pagimin e këtij tatimi në kohën e realizimit të transaksionit; si dhe (vi) nga ana e vjehtërit nuk është hezitur në asnjë moment që ky tatim të mos paguhej dhe ka qenë gjithmonë i gatshëm për pagimin e tij.

17.6.17 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar, arsyeton si vijon:

- Nga hetimi administrativ u provua se kjo pasuri është në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit dhe vjehtërit të saj, ku pjesa takuese më e madhe rezulton të jetë e vjehtërit. Trupi gjykues konstaton se detyrimi ligjor që ka vendosur subjektin në pozitën e hetimit mbi vërtetësinë e deklaramit dhe provueshmërinë e burimit të ligjshëm për këtë pasuri është fakti që subjekti e përdor këtë pasuri të deklaruar në deklaratën *Vetting*, pavarësisht se ajo nuk rezulton bashkëpronare apo kontribuuese në të.

Në këtë drejtim, trupi gjykues, lidhur me këto të ardhura, vlerëson se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës duhet të përmbushen dy elementet kumulative:

a) Të ardhurat të jenë përfituar në mënyrë të ligjshme – lidhur me këtë kërkesë të ligjit, trupi gjykues vlerëson se në këtë çështje objekt shqyrtimi nuk evidentohen problematika, për sa kohë nga hetimi u provua se shuma është përfituar po nga vjehtëri i subjektit nëpërmjet transaksionit bankar dhe se provohet fakti që kjo shumë ka ekzistuar dhe ka kaluar për blerje të pjesës takuese të tij në pasurinë objekt hetimi. Po ashtu u provua se kjo shumë është tërhequr po nga vjehtëri i subjektit dhe kishte pasur si destinacion blerjen e pjesës së tij takuese në pasurinë në bashkëpronësi.

b) Të jenë paguar detyrimet tatimore – lidhur me këtë çështje, trupi gjykues, në rrethanat objekt vlerësimi, konstaton se në këtë rast detyrimi për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në shumën 5.000.000 lekë nga shitja e pasurisë u krye përgjatë hetimit administrativ, provuar me dokumentin “urdhërpagesë ***, Tatimi mbi të Ardhurat Individuale”, datë 26.1.2023, në emër të vjehtërit të subjektit, i cili nuk ka qenë ndonjëherë subjekt deklarues.

Trupi gjykues këtë çështje e vlerëson duke analizuar rrethanat faktike të saj kundrejt pozitës së subjektit në këtë pasuri, sjelljet e saj në këtë proces në raport me detyrimet ligjore, për efekt të ligjit nr. 84/2016, duke evidentuar rrethanat specifike, ku përgjatë procesit rezultoi e provuar se:

- i)** Subjekti nuk është individ që e ka krijuar këtë pasuri, pasi nuk rezulton palë kontraktuese dhe kontribuuese në të.
- ii)** Në këndvështrimin substancial kjo shumë ka rezultuar me burim të provuar, e përfituar po nga vjehtëri i subjektit nëpërmjet transaksionit bankar;
- iii)** PAGESA E DETYRIMEVE TATIMORE ISHTE DETYRIM I NJË TJETËR PERSONI - vjehtërit të saj dhe jo direkt i subjektit të rivlerësimit, detyrim i përmbushur sapo subjekti është vënë në dijeni të faktit nëpërmjet pyetësorëve të bërë nga Komisioni.

iv) Vjehri i saj duket të jetë ndodhur në një situatë komplekse lidhur me pagimin e detyrimit tatimor, për shkak se nga viti 2008, kur dhe ka shitur pasurinë me deklaratën noteriale, dhe deri në vitin 2015 nuk ishte realizuar shitja e saj që, për rrjedhojë, nuk ishte formalizuar kontrata e shitjes së pasurisë si dokumenti vendimtar që njeh detyrimin tatimor dhe imponon përfituesin e të ardhurave të shlyejë detyrimet tatimore me qëllim regjistrimin e saj dhe, për pasojë, shpjegimet e saj duken bindëse.

- Përveç sa më sipër, trupi gjykues, parë këtë çështje edhe nën një këndvështrim ligjor të një situatë hipotetike, në çdo rast të mundshëm pjesëtimi të kësaj pasurie, pozita e subjektit është vetëm përfituese në pjesën bashkëshortore, që në fakt burimi është krejtësisht i legjitimuar, pasi është blerë me kredi bankare nga bashkëshorti i saj dhe jo në pjesën e vjehrit ku edhe kërkohet ligjshmëria e burimit të krijimit.

Pavarësisht kërkesës së subjektit të situatës së saj, për referim nga Komisioni në vendime të ngjashme, përkatësisht nr. 56/2018 dhe nr. 311/2020, të formës së prerë, trupi gjykues, nën çmuarjen e rrethanave faktiko-ligjore, ku shuma 5.000.000 lekë është investuar përsëri për llogari të pjesës takuese të vjehrit të subjektit, ka konkluduar se ky tatim i paguar me vonesë nga vjehri i saj është një rrethanë që nuk impakton pozitën e subjektit dhe, për pasojë, subjekti është zhveshur në kuptim të ligjit nr. 84/2016 nga ndonjë detyrim i cili do të kondiciononte ligjshmërinë e pasurisë përtej provimit të krijimit të saj prej vjehrit nga burime të ligjshme e të verifikueshme. Këto rrethana dhe sjellja pozitive e subjektit, në përmbushje të detyrimeve ligjore nga vjehri i saj, çmohen të tilla nga trupi gjykues që nuk cenojnë pozitën e subjektit në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 84/2016.

17.6.18 Lidhur me kërkimin tjetër të Komisionit për të depozituar subjekti marrëdhënien kontraktuale me FSHU-në dhe UKT-në, subjekti i rivlerësimit ka depozituar librezat përkatëse, të cilat rezultojnë në emër të bashkëshortit të saj, si dhe ka depozituar pagesat e kryera për këto shërbime nëpërmjet sistemit bankar.

17.6.19 Trupi gjykues, në tërësi të analizës së bërë dhe argumenteve të pasqyruara, arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi këtë pasuri dhe se nuk ngrihen dyshime lidhur me origjinën dhe burimin e krijimit të saj.

17.6.20 Komisioni hetoi në lidhje me kredinë bankare në shumën 3.500.000 lekë.

17.6.21 Nga hetimi¹⁴ rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka marrë kredi në shumën 3.500.000 lekë nëpërmjet kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 30.1.2010, me qëllim likuidimin e çmimit të shitjes së apartamentit. Në kontratë është parashikuar që shuma e disbursuar do të transferohet direkt me transfertë bankare në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., e përfaqësuar nga shtetasi A.Ç.

17.6.22 Në kontratën e kredisë palë kredidhënëse është Banka Kombëtare Tregtare, palë kredimarrëse A.M dhe palë dorëzanëse Gentiana Muçaj, S.M dhe E.M. Kjo kredi është marrë për një afat 240 muaj (20 vjet) dhe si kolateral është vendosur pasuria e llojit “apartament” në pronësi të shtetasit S.M.

17.6.23 Nga verifikimi i *statement*-it rezultoi se kredia është disbursuar në datën 10.2.2010 në vlerën 3.500.000 lekë. Pas disbursimit të saj dhe mbajtjes së komisioneve përkatëse nga banka vërehet se në datën 18.2.2010 është transferuar shuma 3.465.000 lekë në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “për shlyerje detyrimi për blerje apartamenti”.

17.6.24 Komisioni gjithashtu konstatoi se po në të njëjtën datë, 18.2.2010, kur edhe ishte disbursuar kredia, shtetasi A.M.Ç (administratori i shoqërisë “****”) kishte transferuar në llogarinë e shtetasit A.M shumën 452.000 lekë, me përshkrimin “kalim detyrimi”. Subjekti,

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, nga BKT-ja, në dosjen e Komisionit, si dhe aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

lidhur me këtë transaksion, ka sqaruar¹⁵: “Nga ana jonë janë bërë punime të ndryshme nga ato të shoqërisë, të cilat janë specifikuar në procesverbalin e mbajtur nga ana e financierit të shoqërisë në datën 17.2.2010. Në këtë procesverbal pasqyrohen se punimet për pllaka shtrese, pllaka veshjeje, pajisje hidrosanitare, punëtori, bojler, vetratat, dyer të brendshme do të kryheshin nga ana jonë. Shuma totale sipas preventivit të vetë shoqërisë ishte 3.289 euro. Nga llogaria e financierit të shoqërisë *** rezulton se nga shuma 3.500.000 lekë duhet të kthehej për punime të kryera nga ana ime shuma 452.000 lekë, e cila është kthyer në llogarinë e kredisë në emër të A.M në datën 18.2.2010”. Subjekti ka depozituar situacionin për punimet që janë kryer në apartamentin e tyre, si dhe përlllogaritjet financiare të kryera për shumën që duhej kthyer.

17.6.25 Për sa parashtrohet më sipër, duket se nuk konstatohen problematika apo dyshime lidhur me këtë burim krijimi, për sa kohë që si burim i kështit të dytë për blerjen e apartamentit është kredia.

17.6.26 Komisioni kreu analizën (sikurse pasqyrohet në tabelën më poshtë) për të parë mundësinë financiare për të investuar në këtë pasuri. Në analizë u përfshinë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara, si dhe ato të deklaruara gjatë hetimit nga subjekti i rivlerësimit. Në analizë nuk është përfshirë shuma 452.000 lekë, pasi efekti financiar (të ardhura - shpenzime) rezulton të jetë zero, pasi rezultoi se e njëjta shumë që shpenzohet për punimet e brendshme më pas kthehet në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Viti 2009	Viti 2010
1	TË ARDHURA	8,618,128	1,756,727
	Të ardhura nga paga, subjekti	766,182	644,956
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	986,432	1,103,591
	Të ardhura nga interesat bankare	7,014	8,180
	Të ardhura nga vjehtëri nga shitja e pasurisë (e blerë në vitin 2001)	6,858,500	-
2	SHPENZIME	656,108	(2,300,127)
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	449,708	546,480
	Shpenzime qiraje Tiranë (ap. te ***)	180,000	105,000
	Shpenzime mobilimi	-	130,000
	Shpenzime transporti (subjekti + bashkëshorti)	26,400	52,800
	Shpenzime kredia (principal + interes)	-	(3,152,330)
	Shpenzime ekstra kredia	-	17,923
3	PASURI	7,174,431	3,404,396
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	Kontratë sipërmarrjeje ap. 108.75 m ² , datë 28.12.2009 (50.000 euro vjehtëri dhe 25.000 euro bashkëshorti me kredi	6,858,500	3,465,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	315,931	(60,604)
	DIFERENCA (1-2-3)	787,589	652,457

17.6.27 Nga analiza financiare duket se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të investojnë në blerjen e apartamentit, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

17.7 Komisioni hetoi edhe në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit të saj dhe shoqërisë “****” sh.p.k., me

¹⁵Me pyetësorin nr. 8, datë 6.2.2023.

ortak dhe administrator shtetasin A.Ç. Subjekti lidhur me këtë çështje ka depozituar¹⁶ vërtetimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë¹⁷ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁸, nga ku vërehet se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë zhvilluar procese gjyqësore apo hetuar çështje penale¹⁹ në ngarkim të kësaj shoqërie, administratorit të saj apo çështje të vëna në lëvizje prej tyre, etj. dhe, për pasojë, nuk konstatohet ndonjë situatë e konfliktit të interesit. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar dhe ka provuar me dokumentacion rastin e zhvillimit të një procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, që i përket çështjes administrative nr. *** akti, datë 1.2.2018, ku njëra prej palëve ndërgjyqëse kundërshton lejen e ndërtimit të dhënë në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe se paraprakisht nga shorti i zhvilluar padia i ka takuar për gjykim vetë subjektit. Në vijim subjekti ka paraqitur në datën 1.2.2018, përpara kryetarit të gjykatës kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, me arsyetimin se bashkëshorti dhe vjehri i saj njëkohësisht kanë nënshkruar me këtë shoqëri një kontratë sipërmarrjeje të një apartamenti dhe se bashkëshorti ka ende një detyrim të pashlyer. Më tej, kryetari i gjykatës, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2018, ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për heqje dorë nga gjykimi i çështjes.

18. Automjet tip “Daimler Benz A Class”, blerë në datën 5.7.2012, me kontratën e datës 5.7.2012, në shumën 1.000 euro. Vlera: 1.000 euro. Bashkëpronësi në tërësi të shtetasit A.M. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁰.

Hetimi i Komisionit

18.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, me përshkrimin “Blerë një automjet tip ‘Daimler’, lloji ‘A Class 170’, targa ***, në emër të bashkëshortit A.M. Blerë me kursime në vlerën 1.000 euro plus TVSH-në dhe taksat e regjistrimit të mjetit, rreth 50.000 lekë”.

18.2 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, kjo e fundit informon²¹ se shtetasi A.S.M ka të regjistruar automjetin me targa ***. Nga dokumentacioni i administruar nga kjo drejtori konfirmohet blerja e këtij automjeti në vlerën 1.000 euro, me kontratë shitjeje datë 5.7.2012, me palë shitëse B.K dhe palë blerëse A.M.

18.3 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti me deklaratën *Vetting*, rezulton se automjeti është zhdoganuar në datën 4.9.2012 dhe vlera e TVSH-së e paguar për zhdoganimin e tij është në shumën 38.234 lekë.

18.4 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2012 (sikurse pasqyrohet në tabelën më poshtë) kur është investuar në blerjen e këtij mjeti, duke përfshirë edhe shpenzimet ekstra në shumën 50.000 lekë për këtë mjet, sipas deklaratimit të subjektit. Në këtë shumë është përfshirë vlera e TVSH-së për zhdoganimin e mjetit, si dhe taksat për regjistrimin e tij.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	Viti 2012
1	TË ARDHURA	1,979,574

¹⁶Me pyetësorin nr. 9, datë 13.2.2023.

¹⁷Nr. *** prot., datë 13.2.2023.

¹⁸Nr. *** prot., datë 14.2.2023.

¹⁹Sipas shkresës nr.*** prot., datë 14.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe shkresës nr. *** prot., datë 14.2.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

²⁰Kontratë shitjeje datë 5.7.2012, me palë shitëse B.K dhe palë blerëse A.M, të mjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 1.000 euro; mandatpagesë datë 5.7.2012, në vlerën 1.000 euro; leje qarkullimi i automjetit të vendit të origjinës, Gjermani; deklaratë doganore datë 4.9.2012; urdhër çlirimi, leje qarkullimi, në emër të shtetasit A.M, të mjetit me targa ***; certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor, me targa ***, datë 7.9.2012, në emër të shtetasit A.M; mandatarkëtim nr. *** për doganën Tiranë, në shumën 38.400 lekë, për zhdoganim (shihni aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së).

²¹Me shkresën nr. *** prot., datë 16.9.2020.

	Të ardhura nga paga, subjekti	951,676
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	1,020,537
	Të ardhura nga interesat bankare	7,361
2	SHPENZIME	1,161,169
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096
	Shpenzime për taksat e mjetit të blerë në vitin 2012	50,000
	Shpenzime mobilimi	63,000
	Shpenzime transporti, subjekti	96,800
	Shpenzime kredia (principal + interes)	369,326
	Shpenzime ekstra kredia	17,946
3	PASURI	244,790
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet tip “Daimler”, me targa *** (5.7.2012)	139,720
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	105,070
	DIFERENCA (1-2-3)	573,616

18.5 Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të investojnë në blerjen e automjetit, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

Detyrime financiare

19. Kredi e marrë për shtëpinë, në shumën 3.500.000 lekë, me kontratë nr. ***, datë 30.1.2010. Pagaru principal dhe interesi 2.321.135,11 lekë. Detyrimi financiar i mbetur është në vlerën 2.763.986,21 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²².

Hetimi i Komisionit

19.1 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se me kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 30.1.2010, nënshkruar midis BKT-së dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A.M, me cilësinë e kredidhënësit, këtij të fundit i është miratuar kredia në shumën 3.500.000 lekë, ku sipas aneksit të çeljes dhe përdorimit të kredisë të nënshkruar po në të njëjtën datë thuhet se kreditimi do të përdoret për blerje apartamenti. Sipas aneksit të elementeve specifike të kredisë, datë 30.1.2010, thuhet se shuma e disbursuar do të transferohet direkt me transfertë bankare ndërmjet BKT-së në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi A.Ç.

19.2 Nga korrespondenca e Komisionit me BKT-në²³, kjo e fundit informon se detyrimi i mbetur deri në datën 27.1.2017 është në vlerën 2.763.986,21 lekë.

19.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se disbursimi i kredisë është bërë në datën 10.2.2010 dhe në datën 18.2.2010 rezultoi se shuma 3.465.000 lekë ka kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “për shlyerje detyrimi për blerje apartamenti”.

Deklarimi i bashkëshortit të subjektit, z. A.M

²²Kontratë kredie nr. ***, datë 30.1.2010, me BKT-në, kredimarrës A.M dhe dorëzanës Gentiana Muçaj, S.M dhe E.M, në shumën 3.500.000 lekë. Sigurimi i kredisë është vendosur mbi apartamentin me sip. 115.82 m², e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 17.11.2000, me nr. pasurie ***, në z. k. ***, rruga “****”, prapa ***, në emër të shtetasit S.M. Aneksi i çeljes dhe përdorimit të kredisë, qëllimi i kredisë është për blerje apartamenti; vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga BKT-ja, i cili konfirmon se shtetasi A.M ka marrë kredi në shumën 3.500.000 lekë, me dorëzanëse Gentiana Muçaj. Principali i paguar është në vlerën 2.321.135 lekë dhe detyrimi i mbetur i kredisë është 2.763.986.21 lekë (shihni aneksin nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

²³Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

20. Llogari në emër të djalit E.M, në “Intesa Sanpaolo Bank” (kursime), në vlerën 3.331,15 USD. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës²⁴ nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku thuhet se në emër të E.M ka llogari bankare në vlerën 3.331 USD.

20.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2020, informon se E.M ka llogari kursimi në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 3.331,15 USD.

21. Llogari në lekë në “Raiffeisen Bank” (kursime), në emër të R.M, në vlerën 105.034,12 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës²⁵ nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, nga “Raiffeisen Bank” në emër të R.M, në vlerën 105.036 lekë.

21.1 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, informon se R.M ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 105.036,36 lekë.

22. Llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 27.7.2000, çelur me 500.000 lekë, bono thesari nga shpërblimet e punësimit ndër vite. Gjendja në datën e deklarimit 58.734,53 lekë, në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës²⁶ nxjerrje llogarie datë 26.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, ku konfirmohet llogari në emër të shtetasit A.M, me gjendje 8.750,93 lekë. Konfirmohet çelja e llogarisë në vlerën 500.000 lekë.

22.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2020, informon se shtetasi A.M ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 8.750,93 lekë.

23. Llogari në lekë në “Raiffeisen Bank”, me gjendje 106.417,79 lekë, honorare në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës²⁷ vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, ku thuhet se në emër të shtetasit A.M ka llogari rrjedhëse me gjendje 113.193 lekë.

23.1 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, informon se shtetasi A.M ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 113.193,08 lekë.

24. Llogari në euro në Raiffeisen Bank”, me gjendje 0 (zero) euro, në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës²⁸ vërtetimin nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasit A.M, i cili ka dy llogari bankare në euro me gjendje 0 (zero) euro dhe 1 euro.

24.1 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, informon se shtetasi A.M ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 1,58 euro.

25. Llogari page në lekë, në “Credins Bank”, datë 31.12.2016, gjithsej 25.448,01 lekë, në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës²⁹ shkresën nr. *** prot., datë 28.7.2017, të “Credins Bank”, ku konfirmohet në emër të shtetasit A.M llogari page me gjendje 7.161 lekë, në datën 27.1.2017, si dhe fakti se diferenca në vlerën 18.287 lekë është për shkak se subjekti i referohet gjendjes në datën 31.12.2016, kurse informacioni i kërkuar është në datën 27.1.2017.

²⁴Shihni aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵Shihni aneksin nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶Shihni aneksin nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁷Shihni aneksin nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁸Shihni aneksin nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁹Shihni aneksin nr. 4/19 në dosjen e ILDKPKI-së.

25.1 “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2020, informon se shtetasi A.M ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 7.161,01 lekë.

26. Shuma 450.000 lekë kursime, jashtë sistemit bankar. Bashkëpronësi në tërësi.

26.1 Bashkëshorti i subjektit (subjekt deklarues edhe ky prej vitit 2015) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 ka deklaruar kursime nga pagat e deklarueses dhe të bashkëshortit A.M (jo në sistemin bankar) në vlerën 450.000 lekë, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2016 bashkëshortët nuk kanë deklaruar shtesa apo pakësime, pra gjendja ka mbetur e pandryshuar. Për pasojë, kjo shumë është mbartur edhe në deklaratën *Vetting*.

26.2 Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2015 - 2016 (sikurse pasqyrohet në tabelën më poshtë) për të parë mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes për të krijuar këto kursime.

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	Viti 2015	Viti 2016
1	TË ARDHURA	2,193,721	2,149,459
	Të ardhura nga paga subjekti	1,141,600	1,173,619
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	1,048,696	974,012
	Të ardhura nga interesat bankare	3,425	1,828
2	SHPENZIME	1,540,297	1,775,870
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	897,104	940,368
	Shpenzime qiraje Gjirokastër (bashkëshorti)	52,000	156,000
	Shpenzime qëndrimi Gjirokastër + transport	86,100	96,000
	Shpenzime TIMS	28,346	214,326
	Shpenzime kopshti i djalit (Roan)	168,000	84,000
	Shpenzime kredia (principal + interes)	289,864	268,722
	Shpenzime <i>extra</i> kredia	18,883	16,454
3	PASURI	393,055	(11,402)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	393,055	(11,402)
	DIFERENCA (1-2-3)	260,369	384,990

26.3 Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi në krijimin e kursimeve *cash*, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

27. Llogari në euro në BKT, gjendja 284,25 euro honorarë në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës³⁰ vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga BKT-ja, ku në emër të shtetasit A.M ka llogari bankare në vlerën 284,25 euro.

27.1 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, informon se shtetasi A.M ka llogari në këtë bankë me gjendje në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting* në vlerën 282,75 euro.

28. Kartë krediti pa përdorur në BKT, në shumën 30.000 lekë, në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi.

³⁰Shihni aneksin nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

28.1 Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion. BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017³¹, konfirmon se shtetasi A.M ka kartë krediti me limit 30.000 lekë (e papërdorur), në datën 27.1.2017.

28.2 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020 dhe dokumentacionin e depozituar konfirmon kartën e kreditit në emër të shtetasit A.M, me limit 30.000 lekë.

29. Llogari kredie në lekë në BKT, me gjendje 88.936.781, në emër të shtetasit A.M. Bashkëpronësi në tërësi. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës³² vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga BKT-ja, ku në emër të shtetasit A.M ka llogari bankare në vlerën 88.936,71 lekë.

29.1 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, informon se shtetasi A.M ka llogari me gjendje në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 55.642,78 lekë. Deklarimi i subjektit korrespondon me gjendjen e datës 31.12.2016.

29.2 Lidhur me të gjitha llogaritë bankare dhe kursimet e deklaruara në deklaratën *Vetting*, analizimi i tyre nga Komisioni është kryer për çdo vit dhe njëkohësisht ato janë përfshirë të detajuara në analizën financiare, nga ku nuk rezultuan problematika mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj për t'i krijuar ato.

Gjetje të tjera

30. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtin trung me familjarët e bashkëshortit, Komisioni hetoi për pasuri të mundshme në emër të familjarëve.

30.1 Gjatë hetimit, nga verifikimi i regjistrit noterial dhe depozitimi i kontratës noteriale nga noteri publik, rezultoi se vjehri i subjektit të rivlerësimit ka blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 6.8.2013, pasurinë apartament me sip. 62.64 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 8.25 m², në Shëngjin, Lezhë. Sipas kontratës çmimi i pasurisë është në vlerën 3.758.400 lekë, e cila sipas parashikimit kontraktor është likuiduar totalisht nga blerësi dhe ku pala shitëse ka deklaruar se e ka marrë tërë shumën dhe nuk paraqet asnjë pretendim për to.

30.2 Komisioni i ka kërkuar³³ subjektit të deklarojë mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie, si dhe burimin e krijimit. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar: *“Për blerjen e këtij apartamenti vjehri im disponon dy mandate: (i) mandatin nr. 16, datë 30.7.2011, në shumën 10.000 euro; dhe (ii) mandatin nr. 19, datë 15.3.2012, në shumën 10.000 euro. Pagesën e fundit e ka bërë në vitin 2013, para marrjes së certifikatës së pronësisë duke shlyer pjesën e mbetur të detyrimit dhe vlerën e disa punimeve shtesë. Për shkak të distancës nga Tirana dhe angazhimeve në punën e tij, vjehri ishte në pamundësi të ndiqte punimet dhe, për këtë arsye, i kërkoj shoqërisë ndërtuese të kryente dhe ndiqte ajo punimet shtesë. Shoqëria ndërtuese i realizoi punimet shtesë dhe për këtë është paguar nga vjehri im”*.

30.2.1 Nga verifikimi i mandateve rezultoi se me mandatin nr. ***, datë 30.7.2011, vjehri i subjektit ka shlyer këstin e parë të pasurisë në shumën 10.000 euro. Me mandatin e dytë nr. ***, datë 15.3.2012, vjehri i subjektit ka bërë shlyerjen përfundimtare të apartamentit. Mbetet e paqartë arsyeja e pagesave në vitet 2011 dhe 2012 (pra, ku është bazuar kryerja e tyre, pasi duket se kontrata e shitjes nuk pasqyron një akt të mëparshëm mes palëve për këtë pasuri) në raport me nënshkrimin e kontratës së shitjes së pasurisë në gusht të vitit 2013.

30.3 Subjekti³⁴ depozitoi vërtetimin hipotekor, lëshuar në datën 7.8.2013 nga ZVRPP-ja Lezhë, nga të dhënat e së cilës konstatohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 7.8.2013, është

³¹Shihni aneksin nr. 8 në dosjen e ILDKPKI-së.

³²Shihni aneksin nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

³³Me pyetësorin nr. 7, datë 25.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁴Me pyetësorin nr. 8, datë 6.2.2023.

regjistruar në emër të shtetasit S.N.M, vjehri i subjektit, pasuria nr. ***, e cila nga verifikimet përkatëse rezulton e njëjtë me pasurinë e shitur sipas kontratës së lartpërmendur.

30.4 Komisioni hetoi edhe lidhur me titullarin e kontratës së energjisë elektrike në këtë pasuri, nga ku u konfirmua³⁵ se është z. S.M dhe se pagesat kanë filluar prej vitit 2014 e në vijim, sikurse konfirmohen në librezën e energjisë të depozituar nga subjekti. Subjekti depozitoi edhe librezën e UKT-së, ku gjithashtu konfirmohet si titullar i saj z. S.M. Nga verifikimi i librezën rezulton se ajo i përket kontratës nr. *** dhe se pagesat për këtë shërbim kanë filluar prej korrikut 2013.

30.5 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit të saj dhe shoqërisë “***” sh.p.k.. Subjekti lidhur me këtë çështje ka depozituar³⁶ vërtetimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë³⁷ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁸, nga ku vërehet se ajo nuk ka zhvilluar procese gjyqësore me këtë shoqëri, administratorin e saj etj. dhe që për pasojë nuk konstatohet e ndodhur ndonjëherë në situatën e konfliktit të interesit.

30.6 Ndërsa për burimin e krijimit subjekti ka deklaruar se³⁹: “*Kjo banesë është blerë me kursimet e krijuara në vite nga të ardhurat e vjehrrit tim S.M, vajzës së tij R.M dhe vjehrrës sime E.M*”.

30.7 Komisioni hetoi mbi mundësinë financiare të tyre për të investuar në këtë pasuri.

30.8 Nga dokumentacioni i administruar, i depozituar gjatë hetimit si nga subjekti edhe nga institucionet publike dhe jopublike⁴⁰, rezultoi se:

- të ardhurat nga punësimi për vjehrrin e subjektit për periudhën 1994 – 2012 janë në shumën 13.916.076 lekë, gjithashtu ai ka siguruar të ardhura edhe nga projektet dhe bashkëpunimet e Qendrës Studimore Albanologjike me institucione të huaja (Francë, Greqi etj.), të cilat nuk janë përfshirë në këtë shumë;
- të ardhurat nga pensioni për vjehrrën e subjektit për periudhën 1996 – 2012 janë në shumën 1.789.971 lekë;
- të ardhurat nga punësimi për kumatën e subjektit (motrën e bashkëshortit) për periudhën 2001 – 2012 janë në shumën 7.748.898 lekë.

30.9 Komisioni kreu analizën financiare me të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për blerjen e kësaj pasurie, nga ku konstatoi se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

30.10 Pavarësisht rezultatit pozitiv të mundësive financiare, Komisioni⁴¹ i kërkoi subjektit: (i) të jepte shpjegime në lidhje me likuidimin e kësaj pasurie, pasi vërejtë se deklarimi i subjektit gjatë hetimit se *pagesa e fundit është bërë në vitin 2013 para marrjes së certifikatës së pronësisë*, nuk përputhej me përshkrimin e bërë në mandatpagesën nr. ***, datë 15.2.2012, ku citohej *shlyerje përfundimtare për ap. 4*; (ii) të deklaronte nëse nga ana e saj dhe bashkëshortit është përdorur ndonjëherë kjo pasuri, si është përdorur ajo ndër vite dhe nga kush është përdorur; (iii) për kërkimet e Komisionit iu kërkua të depozitonte çdo dokumentacion të vlerësuar në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

30.11 Subjekti, në parashtrimet e saj në lidhje me mospërputhjen e vërejtur mes deklarimit të saj dhe përshkrimit të bërë në mandatin e depozituar, ka depozituar si provë të re kontratën e

³⁵Me librezën e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të kërkesës së Komisionit me email-in datë 14.2.2023.

³⁶Me pyetësorin nr. 8, datë 6.2.2023.

³⁷Nr.*** prot., datë 7.2.2023.

³⁸Nr.*** prot., datë 7.2.2023.

³⁹Pyetësor nr. 5, datë 23.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁰Statement nga “Raiffeisen Bank”.

⁴¹Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

porosisë nr. ***, datë 30.7.2011, nënshkruar nga vjehri i saj me shoqërinë ndërtuese, për të cilën sqaron se porositësi detyrohej të paguante në favor të shoqërisë vlerën 24.000 euro dhe, në vijim, ka shpjeguar si vijon:

- i) Për këtë vlerë janë depozituar dy mandate që i përkasin pagesës së shumës 10.000 euro në vitin 2011 dhe 10.000 në vitin 2012, duke mbetur vetëm shuma 4.000 euro për t'u paguar.
- ii) Pagesat e kësteve janë bërë sipas parashikimeve kontraktore, pra 10.000 euro me nënshkrimin e kontratës në datën 30.7.2011 dhe pagesa e dytë në datën 15.3.2012, sikurse është parashikuar në kontratën e porosisë se do të kryhej brenda muajit mars 2012.
- iii) Vlera e mbetur është paguar me marrjen e hipotekës, pasi vjehri u vu në dijeni se ishte bërë hipoteka e objektit dhe ai atëherë nënshkroi kontratën e shitjes, duke bërë edhe pagesën e mbetur, si dhe për disa punime të vogla shtesë.

30.12 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, vëren se parashikimet kontraktuale bërë në kontratën e porosisë datë 30.7.2011 hedhin dritë plotësisht në sqarimin e mospërputhjes së konstatuar në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri. Në analizë të parashikimeve ligjore të kësaj kontrate gjendet i bazuar përshtkrimi i bërë në mandatin e dytë të kryerjes së pagesës në vitin 2012, si pagesë përfundimtare për faktin se shuma e mbetur prej 4.000 euro ka qenë e lidhur ngushtësisht me marrjen e hipotekës. Në këto kushte konstatohet se detyrimi vijues është i ndërlidhur me përgjegjësinë e kompanisë ndërtuese për të përfunduar regjistrimin e pasurisë.

30.13 Në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se ky apartament nuk është përdorur asnjëherë nga ana e saj dhe e familjes së saj qoftë për pushimet vjetore, qoftë edhe për ndonjë fundjavë. Subjekti ka deklaruar se ky apartament është përdorur nga vjehri dhe familja e tij.

30.14 Në përfundim për këtë çështje, trupi gjykues nuk ngre dyshime për titullarin e pasurisë dhe as për burimin e krijimit të saj.

31. Në DPV-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e një automjeti tip "Audi A6", me targa ***, në emër të shtetasit A.Q, në shumën 500.000 lekë.

31.1 Komisioni e ka pyetur⁴² subjektin për këtë automjet, për burimin e krijimit, si dhe i ka kërkuar të depozitonte dokumentacion justifikues. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar: *"Në vitin 2005 kam blerë nga shtetasi A.Q, djali i xhaxhait të babait tim një mjet 'Audi' me targa ***, në shumën 500.000 lekë. Nuk kam bërë kontratë blerjeje me këtë shtetas dhe nuk kam bërë ndryshim të pronësisë së mjetit, megjithëse e kam deklaruar këtë pasuri në ILDKPKI në të njëjtën mënyrë siç po e deklaroj përsëri. Ka qenë në pronësi 100% të familjes sime dhe e kam përdorur këtë mjet me të njëjtën targë deri në vitin 2010. Mjeti është çregjistruar përfundimisht duke dalë jashtë përdorimit në datën 28.7.2017".*

31.1.1 Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të të ardhurave: *"Në vitin 2005 kam marrë overdraft në 'Raiffeisen Bank', bankë në të cilën merrja pagën si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë. Në datën 18.7.2005 kam tërhequr nga llogaria 300.000 lekë (nga overdrafti) dhe në datën 28.7.2005 kam tërhequr 150.000 lekë (nga overdrafti). Me shumën 450.000 lekë nga overdrafti plus edhe 50.000 lekë kursime kam bërë pagesën cash pronarit të mjetit A.Q".*

31.2 Nga hetimi i kryer Komisionit i rezultoi se ky automjet nuk është konfirmuar nga DPSHTRR-ja në emër të subjektit dhe as i regjistruar ndonjëherë në emrin e saj.

⁴²Pyetësor nr. 2, datë 10.11.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

31.3 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 se ka përfituar shumën 600.000 lekë të ardhura nga shitja e këtij automjeti. Komisioni nuk vlerësoi të marrë në konsideratë këtë shumë, pasi nuk provohet me dokumentacion blerja dhe shitja e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit. Ky automjet rezulton të jetë regjistruar në emrin e babait të subjektit, i cili e ka blerë këtë mjet nga shtetasi A.Q⁴³ në vitin 2009 dhe më pas e ka shitur atë në vitin 2010⁴⁴, në vlerën 600.000 lekë.

31.4 Komisioni kreu analizën financiare (sikurse pasqyrohet në tabelën më poshtë) për të konkluduar mbi mundësitë e subjektit për të investuar në blerjen e kësaj pasurie, nga ku nuk i rezultuan problematika.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	Viti 2005
1	TË ARDHURA	1,723,673
	Të ardhura nga paga subjekti	768,307
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	955,366
2	SHPENZIME	401,271
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	328,671
	Shpenzime transporti	72,600
3	PASURI	632,428
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Autoveturë tip “Audi A6”, me targa ***	500,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	132,428
	DIFERENCA (1-2-3)	689,974

31.5 Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të investojë në blerjen e këtij automjeti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

31.6 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime bindëse mbi arsyet e mosregjistrimit të këtij automjeti në emrin e saj.

31.7 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në këtë periudhë (automjeti është deklaruar i blerë në vitin 2005) është e njohur publikisht vështirësia shumë e madhe në kryerjen e veprimeve periodike me automjetet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, për shkak të radhëve shumë të mëdha”.*

31.7.i Sipas subjektit, angazhimi në punë i bashkëshortit krijonte vështirësi për kryerjen e veprimeve periodike vjetore në lidhje me automjetin, pra mosndryshimi i pronësisë së këtij automjeti nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër përveç sa më sipër, thjesht lehtësira në kryerjen e veprimeve periodike pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Berat.

31.7.ii Në vijim, subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është blerë nga ana e tyre me kursime dhe *overdraft*, si dhe është deklaruar pranë ILDKPKI-së si në momentin kur është blerë ashtu edhe në momentin kur ky automjet është shitur, megjithëse nuk figuronte në emrin e saj apo të bashkëshortit në asnjë regjistër publik. Gjithashtu, subjekti ka theksuar se të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie nuk rezultojnë të jenë investuar në ndonjë pasuri tjetër.

31.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, i vlerëson bindëse ato dhe, për pasojë, nuk vëren problematika në lidhje me këtë pasuri, për më tepër kur të ardhurat provohen se nuk janë deklaruar për të justifikuar ndonjë pasuri, por edhe për faktin se edhe duke mos i

⁴³Me kontratën nr. ***, datë 14.4.2009, depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022.

⁴⁴Me kontratën nr. ***, datë 24.2.2010, depozituar nga subjekti i rivlerësimit me pyetësorin nr. 2, datë 10.11.2022.

marrë në konsideratë këto të ardhura sikurse është vepruar, analiza financiare rezulton në balancë pozitive.

31.9 Komisioni hetoi edhe në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit të saj dhe z. Q. Për këtë çështje, subjekti ka depozituar⁴⁵ vërtetimet përkatëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë⁴⁶ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁴⁷, nga ku vërehet se ajo nuk ka zhvilluar procese gjyqësore me këtë shtetas dhe që, për pasojë, nuk konstatohet ndonjë situatë e konfliktit të interesit.

32. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike⁴⁸ si AMF, Policia e Shtetit për hyrje-daljet, Ministria e Drejtësisë si administruese për regjistrin noterial, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automatësh, dalje në sistemin TIMS me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit, përveçse atyre të identifikuar gjatë hetimit.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

33. Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara në procesin e rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e saj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në kreun IV të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

34. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.12.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gentiana Muçaj.*

Hetimi i Komisionit

35. Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁵Me pyetësorin nr. 8, datë 6.2.2023.

⁴⁶Nr. *** prot., datë 7.2.2023.

⁴⁷Nr. *** prot., datë 7.2.2023.

⁴⁸Shkresat: nr. *** prot., datë 28.9.2020, nga AMF-ja; nr. *** prot., datë 17.9.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; si dhe nr. *** prot., datë 20.1.2023, nga Ministria e Drejtësisë.

36. Nga informacioni i përditësuar⁴⁹ nga organet ligjzbatuese duket se nuk rezultojnë të dhëna të tjera lidhur me kontrollin e kriterit të figurës.

36.1 Komisioni, në vijim si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

36.2 Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

37. Raporti⁵⁰ për analizimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, si dhe (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

38. Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

Sipas të dhënave nga databaza e ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Gentiana Muçaj janë paraqitur 6 ankesa (1 ankesë në vitin 2014, 3 ankesa në vitin 2015 dhe 2 ankesa në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së, 3 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se 1 prej tyre, e vitit 2014, zgjidhet përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta dhe 2 të vitit 2015, me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë. Tri ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon: (i) 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është dërguar për trajtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (ii) 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është dërguar për trajtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (iii) 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje.

⁴⁹Me shkresat nr. *** prot., datë 22.4.2022 dhe nr. *** prot., datë 21.11.2022, informohet se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.

⁵⁰Nr. *** prot., datë 24.12.2021, të KLGJ-së.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtaren Gentiana Muçaj, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

39. Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLD. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”, ndërsa 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

39.1 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj ka shfaqur aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Gentiana Muçaj kualifikon drejt marrëdhënien juridike objekt shqyrtimi gjyqësor dhe, në përgjithësi, zgjidh saktë çështjet në themel.

Nga 8 vendime të vëzhguara vetëm në dy raste vendimet e dhëna prej saj e të ankimuara janë ndryshuar pjesërisht nga gjykata më e lartë, ndërsa tri vendime të ankimuara janë lënë në fuqi. Asnjë nga vendimet e cenuara nuk është prishur, ndryshuar për shkelje procedurale me pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Gjyqtarja Gentiana Muçaj identifikon saktë ligjin e zbatueshëm për marrëdhëniet e punës, në rastin e personave marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës. Gjithashtu, gjyqtarja Gentiana Muçaj njeh dhe zbaton ligjet e veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës të funksionarëve të caktuar të shtetit, sikurse është rasti i ushtarakëve apo sikurse është rasti i punonjësve të policisë së burgjeve.

Në zgjidhjen e çështjes administrative, krahas dispozitave të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, kur është rasti, gjyqtarja Muçaj përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre. Kur nevojitet, gjyqtarja përdor praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë në zgjidhjen e çështjeve, madje në një rast në zgjidhjen e çështjes gjyqtarja ka referuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara janë ankimuar 5 prej tyre, ku në 3 raste vendimi është lënë plotësisht në fuqi nga gjykatat më të larta. Dy vendime u cenuan pjesërisht. Tri vendime rezultojnë të paankimuar.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj ka manifestuar aftësitë e duhura në drejtim të arsyetimit ligjor të vendimeve të dhëna prej saj. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimin, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre.

Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme gjithashtu, shoqërohen me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre.

39.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në dy gjykata të ndryshme. Kështu, në periudhën 8.10.2013 – 3.11.2013, znj. Gentiana Muçaj ka kryer detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ndërkohë, në periudhën 4.11.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ajo ka deklaruar se në këtë periudhë (8.10.2013 – 8.10.2016) i janë caktuar për gjykim 2076 çështje dhe ka përfunduar 1910 çështje gjyqësore, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 96 prej tyre. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 92%.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 4.11.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Gentiana Muçaj ka përfunduar gjithsej 1922 çështje, nga të cilat 1150 çështje administrative themeli, 282 çështje marrëdhënie pune dhe 488 çështje të tjera janë administrative pa palë kundërshtare.

Në interpretim të pikës 3, germa “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për 3 vjet.

Ndërkohë, gjyqtarja Gentiana Muçaj, për 3 vjet, ka përfunduar së gjykuari 1432 çështje administrative me palë kundërshtare, pra ka pasur një ngarkesë tri herë më të lartë se standardi sasior i caktuar nga sistemi i vlerësimit.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Gentiana Muçaj ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 5 ditë deri në 3 muaj. Në tri dosjet e tjera kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj dhe 2 muaj e 20 ditë.

Në 5 dosjet e vëzhguara nuk është respektuar afati standard 1-mujor i gjykimit, i parashikuar nga vendimi nr. ***, datë 14.4.2010, i KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”: *“Megjithatë, kemi theksuar në përmbajtje të këtij raporti se ligji specifik nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative’, i miratuar më vonë se vendimi nr. ***, datë 14.4.2010, i KLD-së ‘Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve’, nuk parashikon afate për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallën e parë të gjykimit administrativ, përveç afateve specifike të parashikuara në nenet 25, 26 e 27 të tij, afate që rezultojnë të jenë respektuar nga gjyqtarja Gentiana Muçaj në të pesë dosjet e vëzhguara. Si rezultat, duke qenë një akt normativ i mëvonshëm dhe mbi të gjitha një ligj specifik, atëherë parashikimet e tij prevalojnë në raport me parashikimet e vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së ‘Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve’, në lidhje me afatin e përfundimit të gjykimit administrativ në shkallën e parë të gjykimit.*

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Gentiana Muçaj ka respektuar në 4 raste afatin ligjor 7-ditor të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012.

Vetëm në një rast afati i dorëzimit të vendimit është tejkaluar me 2 ditë (shihni dosjen nr. 2).

Mund të thuhet se gjyqtarja Gentiana Muçaj, pavarësisht numrit të madh të vendimeve të dhëna prej saj në periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar, i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore.

Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 7 ditë nga shpallja, për 6 ditë nga shpallja, si dhe për 9 ditë nga shpallja.

Në periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, për gjyqtaren Gentiana Muçaj janë adresuar 6 ankesa gjithsej në Inspektoratin e ish-KLD-së. Për 4 prej tyre, pas verifikimit, nuk rezultoi asnjë shkelje ligjore në veprimtarinë e kësaj gjyqtareje. Asnjë ankesë nuk është adresuar ndaj gjyqtares për zvarritje gjykimi. Në analizë të të dhënave të mësipërme vlerësohet se subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj është efiçente dhe efektive në çështjet që ka gjykuar.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjyqtarja Gentiana Muçaj ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore. Në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se respekton afatin ligjor 7-ditor për vënien në lëvizje të dosjes dhe kryen me korrektesë veprimet përgatitore të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ku konstatohet se mban procesverbal në dhomë këshillimi, ku i njofton të paditurit aktet dhe i cakton afat atij për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, aktet e paraqitura prej të paditurit ia njofton paditësit, zhvillon seancë përgatitore dhe kur vlerëson se aktet janë të plota e kalon çështjen për gjykim. Duke i kushtuar rëndësi veprimeve përgatitore, ajo e përfundon gjykimin me 1-3 seanca gjyqësore. I kushton rëndësi edhe dokumentimit të veprimeve të kryera, si dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi kërkesat e palëve. Ndjek me rigorozitet radhën e veprimeve procedurale siç përcaktohet nga ligji nr. 49/2012 deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në lidhje me menaxhimin e çështjes nga ana e gjyqtarit, sa i përket organizimit dhe planifikimit të punës nga ana e saj, shkaqet e shtyrjes së seancave etj., nuk konstatohet asnjë problematikë në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit, e cila të jetë bërë shkak për zvarritje të proceseve të gjykuara prej saj, madje mund të thuhet se gjyqtarja Gentiana Muçaj respekton me përpikëri hapat proceduralë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, si në kryerjen në kohë të veprimeve përgatitore në dhomë këshillimi, kryerjen e veprimeve në seancë përgatitore me praninë e palëve, ashtu edhe në zhvillimin e seancave gjyqësore.

Në 5 çështjet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar me 3 seanca, me 4 seanca dhe me 6 seanca. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 22 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 4 prej tyre kanë qenë joproductive. Shkak për dështimin e 4 seancave ka qenë moskryerja e njoftimit të palëve nga shërbimi postar, mungesa e sekretares dhe rënia e seancës në ditë feste zyrtare (Pashkët Katolike).

Nga 8 dokumentet e shqyrtuara nuk rezultoi në asnjë rast që të jetë cenuar ndonjë vendim i gjyqtares Gentiana Muçaj nga gjykatat më të larta për mosrespektim të procedurave gjyqësore me pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosjet e vëzhguara gjyqtarja Gentiana Muçaj ka mbajtur procesverbal në dhomë këshillimi dhe ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo

gjqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpapia, procesverbali i veprimeve përgatitore në dhomë këshillimi, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, konkluzionet me shkrim të palëve, vendimi përfundimtar, ankimi i palëve nëse ka, vendimi i gjykatave më të larta etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

39.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Gentiana Muçaj, për periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj, nga të dhënat e rezultuara nga dosja personale, si dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në Inspektoratin e ish-KLD-së, gjatë periudhës së rivlerësimit profesional 8.10.2013 – 8.10.2016, nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtarës Gentiana Muçaj.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Gentiana Muçaj. Për vetë subjektin e rivlerësimit, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

39.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor, por edhe në diskun që i përket seancave të regjistruara audio është konstatuar se gjyqtarja Gentiana Muçaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Gentiana Muçaj, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Të dhënat

e rezultuara nga shqyrtimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara tregojnë se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Gjyqtarja Gentiana Muçaj i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 15 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për një periudhë trevjeçare. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 19 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVË PROFESIONALE

40. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të miratuar nga KLGJ-ja; dhe (ii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

i) Në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe Grupit të Punës në raportin e tij të vlerësimit, në tërësi duket se nuk i kanë rezultuar problematika thelbësore në lidhje me gjykimin e zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit në të 3 dokumentet ligjore të llojit “vendim gjyqësor”⁵¹, si dhe në 5 dosjet gjyqësore⁵² të përzgjedhura me short.

ii) Rezultoi se çështjet janë vënë në lëvizje brenda afatit 7-ditor, sikurse e parashikon neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe se në të gjitha rastet duket se është disponuar me zbatimin e afatit 10-ditor për të depozituar pala e paditur prapësimet, kërkimet për pyetjen e dëshmitarëve, të ekspertit, konfirmimin e adresave të tyre, etj.

iii) Sikurse ka identifikuar edhe raporti i vlerësimit të KLGJ-së për subjektin, Komisionit i rezultoi si vijon:

iv) Në 3 dokumentet e dorëzuara nga subjekti, nga verifikimet përkatëse rezultoi se: (a) në dy prej tyre, të llojit “vendim gjyqësor” (për dokumentet 2 dhe 3) nuk rezultojnë të dhëna nëse ndaj tyre është ushtruar ankim dhe nëse po, si kanë disponuar gjykatat më të larta; (b) në lidhje me afatin kohor të gjyqimit të çështjeve që i përkasin po 3 dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi rezultoi se në të tria rastet duket se gjykimi ka tejkaluar standardin kohor njëmuor të parashikuar nga neni 5, gema “c” e vendimit të ish-KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Më konkretisht, gjykimi i çështjes që i përket

⁵¹Dokumenti 1 – vendimi gjyqësor nr. ***, datë 29.9.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. them., datë regjistrimi 13.6.2014, që i përket palëve, paditës D.H kundër të paditurit Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; dokumenti 2 – vendimi gjyqësor nr. ***, datë 9.4.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. them., datë regj. 5.2.2015, me palë, paditës D.D kundër të paditurit Ministria e Mbrojtjes; dokumenti 3 – vendimi gjyqësor nr. ***, datë 21.7.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. them., datë regjistrimi 29.1.2016, me palë paditës E.H etj.

⁵²Dosja 1 – çështja administrative nr. *** regjistri them., datë 19.2.2014 regjistrimi, që i përket paditësit S.G kundër të paditurit Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, me objekt “anulimi i vendimit nr. ***, datë 17.2.2014, i organit administrativ të Policisë së Qarkut Tiranë”. Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 28.3.2014; dosja 2 – çështja administrative nr. *** regjistri, datë 4.4.2014 regjistrimi, që i përket paditëses shoqëria “****” kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, etj., përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.7.2014; dosja 3 – çështja administrative nr. *** regjistri, datë 6.2.2015 regjistrimi, që i përket paditësit “****” sh.p.k. kundër të paditurve Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 9.4.2015; dosja 4 – çështja administrative nr. *** regjistri. them., datë 4.2.2016 regjistrimi, që i përket paditësit E.H, kundër të paditurve Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP Mine Peza, Tiranë, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 4.4.2016; dosja 5 – çështja gjyqësore nr. *** regjistri, datë 23.7.2015 regjistrimi, që i përket paditësit M.N kundër të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt “detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 1 (një) viti page, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 6.10.2016.

dokumentit 1 rezultoi se ka zgjatur 2 muaj e 4 ditë. gjykimi i çështjes që i përket dokumentit 2 ka zgjatur 2 muaj e 16 ditë dhe gjykimi i çështjes që i përket dokumentit 3 ka zgjatur 5 muaj e 20 ditë.

v) Ndërsa në lidhje me 5 dosjet e përzgjedhura përmes një sistemi shortimi, nga verifikimet përkatëse rezultoi se: (a) për çështjen administrative nr. *** regjistri, datë 4.4.2014 regjistrimi, me paditës shoqërinë “***” kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (që i përket dosjes nr. 2), gjykimi i saj nga subjekti i rivlerësimit është përfunduar për 3 muaj, më konkretisht në intervalin kohor 7.4.2014 – 7.7.2014; dhe (b) për çështjen gjyqësore nr. *** regjistri, datë 23.7.2015 regjistrimi, që i përket paditëses M.N kundër të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt “detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë në masën 1 viti pagë për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, parashikuar nga neni 155 i Kodit të Punës (që i përket dosjes nr. 5), gjykimi i saj nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 2 muaj e 20 ditë në intervalin kohor 24.7.2015 - 14.10.2015. Ndërkohë, vërehet se një muaj ka qenë leja vjetore, e cila merret në muajin gusht. Pra, gjykimi⁵³ ka zgjatur një muaj e 20 ditë nëse zbritet leja vjetore.

vi) Dukej se kohëzgjatja e gjykimit në të dyja rastet ka tejkaluar afatin standard 1-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

vii) Për sa rezultoi më sipër për të gjitha dokumentet (e llojit “vendim gjyqësor” dhe për 5 dosjet e përzgjedhura nëpërmjet shortit), Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime⁵⁴, si dhe të depozitojë dokumentacion në lidhje me statusin aktual të dy vendimeve gjyqësore ndër tri të përzgjedhur nga vetë subjekti si pjesë e procesit të vlerësimit profesional.

40.1 Subjekti, në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimeve për 8 dosjet e gjykuara, ka sqaruar se ka zbatuar të gjitha dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 49/2012 mbi të cilin është organizuar dhe funksionon Gjykata Administrative, të cilat kanë të bëjnë me caktimin e seancave përgatitore, gjyqësore etj. Subjekti ka sqaruar se ky ligj nuk parashikon afate për përfundimin e gjykimit.

40.2 Subjekti ka shpjeguar se në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative përparësi ka ligji organik, i cili në fakt nuk ka caktuar afate për përfundimin e gjykimit, por ka parashikuar përfundimin në një afat sa më të shpejtë (neni 3). Subjekti, në të dyja raste ka theksuar se zgjatja e gjykimit ka ardhur si rezultat i kryerjes së aktekspertimeve, ndërsa në një rast ka sqaruar se ka takuar edhe leja e pushimeve vjetore.

40.3 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe ligjit të aplikueshëm në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve administrative, konstaton se ligji organik nr. 49/2012 nuk ka parashikuar afate lidhur me përfundimin e çështjeve dhe për sa kohë nuk kanë rezultuar tejzgjatje të afateve për caktimin e seancave përgatitore apo gjyqësore (sikurse ka parashikuar afate ky ligj) dhe në kuadër të një procesi të rregullt ligjor çmon se nuk vërehen problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

40.4 Ndërsa në lidhje me statusin e dy prej vendimeve të dhëna nga subjekti si pjesë e tri vendimeve të depozituara në vlerësimin e saj profesional nga Grupi i Punës në KLGJ, subjekti me parashtrimet e saj ka depozituar shkresën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

⁵³Por gjithashtu, mban në vëmendje faktin se ligji specifik nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative”, i miratuar më vonë se vendimi nr. ***, datë 14.4.2010, i KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallën e parë të gjykimit administrativ, përveç afateve specifike të parashikuara në nenet 25, 26 e 27 të tij dhe se si një akt normativ i mëvonshëm dhe mbi të gjitha një ligj specifik, atëherë parashikimet e tij prevalojnë në raport me parashikimet e vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, në lidhje me afatin e përfundimit të gjykimit administrativ në shkallën e parë të gjykimit.

Tiranë⁵⁵, ku konfirmohet se të dyja dosjet gjyqësore administrohen në Gjykatën e Lartë mbi rekursin e ushtruara nga palët ndërgjyqëse. Informacioni konfirmon se të dyja vendimet e subjektit janë prishur nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

40.5 Subjektit iu kërkua të depozitonte vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit, ku pas verifikimit u konstatua se njëri prej vendimeve ishte prishur për shkelje të rënda procedurale.

40.6 Për çështjen e parë që i përket paditësit D.D, me palë të paditur Ministria e Mbrojtjes, me objekt “shfuqizimi i urdhrin të ministrit të Mbrojtjes ‘Për dalje në lirim oficeri Aktiv’”, me pretendimin se është liruar me pa të drejtë nga detyra e tij në këtë Ministri, ku ka mbajtur gradën “Kolonel”, subjekti ka shpjeguar se ka zbatuar legjislacionin e fushës dhe se në raste të tjera të ngjashme Gjykata Administrative e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim, sikurse vendimmarrjet e saj. Për të provuar këtë fakt ka depozituar me parashtrimet e saj një vendim⁵⁶ të ngjashëm, me të cilin ka vendosur rrëzimin e padisë, duke sqaruar se njëkohësisht Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi. Subjekti ka ripërsëritur se çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë mbi bazë rekursi. Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 19.07.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit.

40.7 Trupi gjykues, pasi verifikoi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit të depozituar nga subjekti, si dhe pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vëren se prishja e vendimit të subjektit dhe pranimi i padisë duket se ka ardhur si rezultat i trajtimit të themelit të çështjes, i analizimit dhe interpretimit në mënyra të ndryshme të legjislacionit të fushës, etj.

Në të tilla rrethana duket se nuk identifikohen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

40.8 Në lidhje me çështjen e dytë që i përket paditëses E.H etj., me të paditur Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe person të tretë shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt “konstatimi i pavlefshmërisë së veprimit administrativ të kryer nga ZVRPP-ja Tiranë”, në bazë të të cilit ka fshirë regjistrimin e titullit të pronësisë të paditësit, ku me anë të vendimit nr. ***, datë 21.7.2016, subjekti ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Nga verifikimi i vendimit rezultoi se ai është prishur në dhomë këshillimi për shkelje të rënda procedurale, duke u vendosur me vendimin nr. ***, datë 5.4.2018, dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, me një tjetër trup gjykues.

40.9 Subjekti ka shpjeguar se vendimi është prishur, pasi nga gjykata më e lartë është vlerësuar se nuk është rregulluar drejt ndërgjyqësia e palëve, për shkak se duhej thirrur si palë e paditur shoqëria “****” sh.p.k., e cila kishte përfituar një pjesë të pronës së paditësve të kthyer me vendim të KKKPronave dhe që më pas e kishte regjistruar në hipotekë.

40.10 Subjekti i është referuar nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile ku, sipas saj, gjykata mund të orientojë paditësin të rregullojë ndërgjyqësinë dhe më tej është në vlerësim të palës ta bëjë këtë. Subjekti edhe në këtë rast bën paralelizëm me vendime të tjera, ku sqaron se vendimet e saj janë lënë në fuqi. Subjekti ka sqaruar se çështja është në Gjykatën e Lartë mbi bazë rekursi.

40.11 Trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit, vërejt se prishja e tij për shkelje të rënda procedurale është bërë bazuar në nenin 161 të Kodit të Procedurës Civile⁵⁷, si dhe në vendimin nr. ***, datë 12.6.2014, të Kolegjit Administrativ të

⁵⁵Nr. *** prot., datë 27.2.2023, të zëvendëskryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁵⁶Referojuni vendimit nr. ***, datë 10.3.2014, administruar në dosjen e Komisionit, së bashku me dy vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nr. ***, datë 2.10.2014 dhe Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 21.3.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁷Neni 161 i Kodit të Procedurës Civile/Bashkëndërgjyqësia/neni 161 (shtuar germa “c” me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008, neni 9)/Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqës) në rast se: a) kanë të drejta ose detyrime të përbashkëta mbi objektin e padisë; b) të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose

Gjykatës së Lartë. Sipas këtij vendimi nuk është ndërtuar drejt ndërgjyqësia, pasi nuk ishte thirrur në gjykim si palë e paditur shoqëria “****” sh.p.k., e cila rezultonte pronare e një pasurie të kundërshtuar nga pala paditëse, sipas së cilës kërkohej fshirja nga hipoteka etj. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ka pasur si referencë në ndryshimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit edhe një vendim të Gjykatës së Lartë, cituar më sipër, sipas të cilit çështja ishte prishur po për shkelje të rënda procedurale dhe ishte kthyer për rigjykim, për shkak se nuk ishte rregulluar drejt ndërgjyqësia, pasi nuk ishte thirrur si palë edhe Komisioni i Ndarjes së Tokës Mamurras, ndërsa kërkohej konstatimi absolutisht i pavlefshëm i AMTP-së, si akt i lëshuar prej tij.

Trupi gjykues, në vlerësimin e çështjes objekt hetimi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka munguar të orientojë palët në rregullimin e drejtë të ndërgjyqësisë, që padyshim më pas janë ato të cilat vlerësojnë ose jo orientimin përkatës.

Duket se gjykata ka dalë në përfundim pa rregulluar më parë ndërgjyqësinë, duke sjellë si pasojë (për shkak të kthimit për rigjykim) rivënien e çështjes në lëvizje përsëri në të njëjtën gjykatë, për të njëjtën çështje gjyqësore, me të njëjtin objekt gjykimi, nën identifikimin e shkeljes procedurale, sikurse është arsyetuar nga Gjykata e Administrative e Apelit Tiranë. Kjo për shkak se në rastin konkret nuk u provua roli orientues i subjektit për rregullimin e ndërgjyqësisë mes palëve në gjykim, fakt i pranuar edhe nga vetë subjekti në shpjegime.

Për sa më sipërsarsetuar, trupi gjykues konstaton se gjykimi në këtë formë pa rregulluar më parë ndërgjyqësinë, nisur edhe nga specifika e objektit të padisë, duket se mundëson zgjatjen e procesit për shkak të kthimit të çështjes dhe vijimit të procesit edhe një herë në shkallë të parë, në ndryshim nga sa parashikohet në nenet 72/2, 74/1,2,3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, si dispozita që identifikojnë indikatorët matës për vlerësimin profesional. Nën këto argumente, trupi gjykues çmon se në këtë çështje ka rrethana të tilla për ta dërguar atë për inspektim të mëtejshëm pranë organit kompetent.

40.12 KLGJ-ja⁵⁸ nuk ka konfirmuar propozim/e për masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit përgjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

C/2. Mbi denoncimet e depozituara pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit

41. Pranë Komisionit janë regjistruar 8 denoncime për subjektin e rivlerësimit, ku një prej tyre rezulton të jetë i përsëritur. Këto denoncime janë administruar dhe vlerësuar nga Komisioni në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, të cilat paraqiten të trajtuara si vijon:

42. Denoncim⁵⁹ i shtetasit A.J

42.1 Denoncuesi ankohet në këtë denoncim lidhur me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 16.10.2017, me objekt “kundërshtimin e veprimeve përmbarimore”, me palë të paditur Zyrën e Përmbarimit. Ai pretendon se subjekti i rivlerësimit në seancë përgatitore ka pranuar një padi të parregullt nga pala paditëse Ministria e Financave, padi e cila referuar këtij pretendimi ishte nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili nuk kishte prokurë apo autorizim përfaqësimi nga ministri për ta paraqitur këtë padi.

42.2 Në vazhdimësi, ai pretendon se parregullsia e kësaj padie nuk u riparua as në seancat e tjera gjyqësore dhe se juristja e Ministrisë së Financave paraqiti një prokurë private të lëshuar nga Sekretarja e Përgjithshme, të cilën gjyqtarja G. Muçaj e pranoi dhe i la për detyrë se duhet

e ligjit kanë po atë bazë; c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur.

⁵⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020.

⁵⁹Nr. *** prot., datë 18.12.2017.

të rregullohet përfaqësimi. Denoncuesi pretendon se juristja e kësaj Ministrie nuk u paraqit më në asnjë nga seancat gjyqësore dhe ky përfaqësim nuk u rregullua.

42.3 Ai pretendon se referuar vendimit nr. ***, datë 16.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ky subjekt rivlerësimi ka penguar ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 8.2.2011, të Gjykatës së Apelit, pra “*më ka mohuar ekzistencën e titullit ekzekutiv*”.

42.4 Në përfundim të këtij denoncimi, ai pretendon se vendimi nr. ***, datë 16.10.2017, nuk përmbush standardet kushtetuese të arsyetimit të një vendimi gjyqësor, ku pjesa arsyetuese e vendimit gjyqësor duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese, duke pretenduar shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

42.5 Komisioni, lidhur me pretendimet e parashtruara më sipër nga denoncuesi, administroi dosjen gjyqësore⁶⁰ nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ku nga aktet u konstatua prania e prokurës së posaçme nr. *** kol., datë 28.7.2017, e noteres M.D, nëpërmjet së cilës duket se shtetasja G.P ka emëruar si përfaqësuese të saj ligjore shtetasen H.J për ta përfaqësuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe pranë Gjykatës Administrative Tiranë, në lidhje me objektin e çështjes së përcaktuar në prokurë.

42.6 Komisioni, nga dëgjesa e CD-së në formatin audio të seancave të zhvilluara lidhur me këtë çështje gjyqësore, konfirmoi se subjekti i rivlerësimit e ka konstatuar faktin se prokura e posaçme e përfaqësimit nga shtetasja G.P nuk legjitimohet. Ajo ka kërkuar nga përfaqësuesja H.J që të rregullojë përfaqësimin ligjor ose, në të kundërt, në seancë gjyqësore të paraqitet vetë znj. G.P, duke e theksuar se kjo prokurë është në kundërshtim me nenin 96 të Kodit të Procedurës Civile, duke e cilësuar pjesëmarrjen e saj në mungesë.

42.7 Nga aktet e administruara në dosjen objekt gjykimi konstatohet se padia është nënshkruar nga znj. P (si përfaqësuese e institucionit) dhe se të gjitha njoftimet i janë adresuar asaj, por hera-herës edhe në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Financave.

42.8 Megjithëse në përmbajtjen e aktit noterial (prokura e përfaqësimit në gjykatë) i përfaqësuar mban cilësinë e një individi dhe jo përfaqësuesi të institucionit, duket se mungesa e saj në vijim të procesit gjyqësor në seancën e radhës, ku edhe është vendosur me vendimin nr. ***, datë 16.10.2017, duke u cilësuar mungesa e palës paditëse, nuk ka përbërë shkak për shtyrje apo pushim të çështjes⁶¹.

42.9 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se vendimi nr. ***, datë 16.10.2017, nuk përmbush standardet kushtetuese të arsyetimit të një vendimi gjyqësor, Komisioni, nga verifikimi i vendimit gjyqësor, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka referuar bazën ligjore, ka pasqyruar faktet e çështjes objekt gjykimi, si dhe disponimin e saj.

42.10 Për sa më sipër nuk u evidentuan problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin e subjektit.

42.11 Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte statusin aktual të vendimmarrjes së saj, si dhe të depozitonte dokumentacionin provues.

42.12 Subjekti ka pasqyruar dispozitivin e vendimit të saj në parashtrime, nga ku vihet re se vendimi nr. ***, datë 16.10.2017, i subjektit të rivlerësimit, me objekt “kundërshtimin e veprimeve përmbartimore dhe anulimin e gjobës së vendosur”, është i paankimueshëm, bazuar në nenin 45/a të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, pra për shkak të vlerës së gjobës nën vlerën 20% të pagës minimale në rang vendi, ky vendim është i paankimueshëm.

⁶⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 11.1.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁶¹Neni 34 i ligjit nr. 49/2012, seanca gjyqësore: 1. Seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj. 2. Mosparaqitja e palëve në seancë nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimin.

42.13 Këtë fakt e konfirmon edhe shkresa e depozituar nga subjekti, nr. *** prot., datë 27.2.2023, e zëvendëskryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

42.14 Në përfundim, trupi gjykues konkludon se nuk vërehen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

43. Denoncim⁶² i shtetasit V.L

43.1 Denoncuesi në këtë denoncim ankohet për subjektin e rivlerësimit Gentiana Muçaj lidhur me veprimet joligjore të saj gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare, për dy çështje gjyqësore:

43.1.i Çështjen gjyqësore nr. ***, datë 22.1.2014, me objekt “fitimin e së drejtës së pensionit suplementar të invaliditetit si ushtarak”, e mohuar kjo e drejtë padrejtësisht nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

43.1.ii Çështjen gjyqësore nr. ***, datë regjistrimi 2.11.2015, për detyrimin e ZVRPP-së Tiranë për regjistrimin e një pasurie të paluajtshme sipas vendimit nr. ***, datë 11.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

43.1.iii Denoncuesi për çështjen e parë pretendon se kjo çështje gjyqësore është zvarritur për gjykim nga gjyqtarja R.S dhe më pas kjo çështje është transferuar në Gjykatën Administrative, e cila, pasi është shortuar, është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj.

43.1.iv Denoncuesi pretendon dhe parashtron ndaj subjektit, përveç zvarritjes së gjykimit për këtë çështje, edhe shkelje procedurale, duke përmendur fakte se: (a) subjekti ditën e zhvillimit të seancës përgatitore, në datën 27.2.2014, në mënyrë të qëllimshme pas përfundimit të kësaj seance ka dhënë vendimin nr. ***, datë 27.2.2014, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në seancë përgatitore; (b) në vendimin gjyqësor subjekti ka shkruar se ka qenë e pranishme përfaqësuesja ligjore e palës së paditur, DRSSH Tiranë, e cila në fakt nuk ka qenë e pranishme në seancën përgatitore; (c) subjekti ka shkruar në vendimin gjyqësor për prezencën e një avokati si përfaqësues ligjor të denoncuesit, avokat me të cilin pretendon se nuk ka pasur asnjë lidhje, pasi këtë çështje gjyqësore e ka ndjekur vetë i shoqëruar nga djali i tij; (ç) vendimi gjyqësor është dhënë pa zhvilluar asnjë seancë të vetme dhe ai/denoncuesi nuk ka pasur dijeni për vendimin e dhënë nga subjekti; (d) kryerja e këtyre veprimeve joligjore nga ana e subjektit ka pasur për qëllim kalimin e afatit ligjor për ankimin ndaj këtij vendimi.

43.1.v Komisioni, lidhur me pretendimet e subjektit të parashtruara më lart, të cilat në dukje lidhen me veprime procedurale të ndërmarra gjatë zhvillimit të një procesi gjyqësor, ka administruar kopje të dosjes gjyqësore përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁶³.

43.1.vi Nga shqyrtimi dhe analizimi i përmbajtjes së akteve në dosje lidhur me çështjen e parë gjyqësore me nr. ***, datë 22.1.2014, me objekt “fitimin e së drejtës së pensionit suplementar të invaliditetit si ushtarak”, Komisioni lidhur me pretendimet e denoncuesit konstaton në vendimin gjyqësor subjekti ka shkruar se ka qenë e pranishme përfaqësuesja ligjore e palës së paditur, DRSSH Tiranë, e cila në fakt nuk ka qenë e pranishme në seancën përgatitore, nga analizimi i akteve në dosje rezultoi se: (a) ajo çështje është regjistruar në datën 22.1.2014 dhe vendimi gjyqësor nr. *** ka përfunduar në datën 27.2.2014; (b) nga aktet në dosje rezultoi të jetë administruar autorizimi i lëshuar nga institucioni publik, ku pala e paditur, DRSSH Tiranë, është përfaqësuar nga znj. R.K në çështjen me palë paditëse V.L; (c) Nga verifikimi i procesverbaleve në dosje rezultoi se janë zhvilluar seancat përgatitore të datës 4.2.2014 dhe në datën 14.2.2014 konstatohet se pala e paditur, Agjencia e Sigurimeve Shoqërore, nuk është paraqitur për shkaqe të paarsyeshme, ndërsa rezultoi se është paraqitur në seancën e radhës e

⁶²Nr. *** prot., datë 25.7.2018.

⁶³Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.1.2023.

datës 27.2.2014; (ç) lidhur me mosparaqitjen e palës së paditur, DRSSH Tiranë, në dy seancat përgatitore të datave 4.2.2014 dhe 14.2.2014, Komisioni, përveç konstatimit të mosprezencës së palës së paditur në këto seanca, vëren se referuar procesverbalit të seancës përgatitore datë 4.2.2014, subjekti ka përshkruar faktin e mosparaqitjes së palës së paditur, *e cila ka dijeni nga fletëthirrja dhe se kjo palë për shkaqe të paarsyeshme nuk është paraqitur*. Ndërsa për seancën e datës 14.2.2014, Komisioni referuar procesverbalit të seancës së kësaj date konstatoi se pala e paditur përsëri nuk është paraqitur për arsye se fletëthirrja për njoftimin e palës së paditur është e pakthyer. Rezultoi se në seancën e datës 27.2.2014 kanë qenë prezente të dyja palët ndërgjyqëse, ku vërehet se avokati i palës paditëse ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i kërkesës së paraqitur prej tij.

43.1.vii Në këto rrethana, Komisioni konstatoi se pala e paditur ka qenë e legjitimuar nga subjekti, dhe se mosprezenca e saj në dy seancat e tjera (4.2.2014 dhe 14.2.2014), si dhe çdo veprim tjetër procedural është pasqyruar në procesverbalet e mbajtura nga sekretaria gjyqësore.

43.2 Lidhur me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka shkruar në vendimin gjyqësor për prezencën e një avokati si përfaqësues ligjor të denoncuesit, avokat për të cilin pretendon se nuk ka pasur asnjë lidhje, pasi këtë çështje gjyqësore e ka ndjekur vetë i shoqëruar nga djali i tij, Komisioni konstatoi se: (i) referuar të dhënave të dala nga aktet në dosje rezulton se denoncuesi ka lëshuar prokurë të posaçme që të përfaqësohet nga djali i tij në këtë çështje; (ii) përfaqësuesi/djali i denoncuesit i ka dhënë të drejtë përfaqësimi avokatit A.T nëpërmjet prokurës së posaçme datë 15.2.2014, që ta përfaqësojë atë në këtë çështje.

43.2.i Referuar përmbajtjes së prokurës së posaçme datë 11.10.2013, vërehet se nuk përcaktohet nëndelegimi i përfaqësimit sipas nenit 67 të Kodit Civil, ku thuhet shprehimisht: *“Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij”*.

43.2.ii Komisioni nga aktet e administruara në dosje vëren se avokat A.T, përfaqësues i palës paditëse, në procesverbalin datë 27.2.2014, ka deklaruar se heq dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit, referuar nenit 39 të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

43.2.iii Komisioni, për sa më sipër, nisur edhe nga fakti se ky denoncues pretendon se kryerja e këtyre veprimeve joligjore nga subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim kalimin e afatit ligjor për ankimin e këtij vendimi, i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me legjitimitetin e avokatit si përfaqësues i paditësit, në raport me tagrat e dhëna në prokurën e denoncuesit.

43.2.iv Subjekti në parashtrimet e saj ka shpjeguar se nëpërmjet prokurës së posaçme nr. ***, datë 11.10.2013, pala ankuese V.L e ka lënë në çmim të përfaqësuesit tagrin për paraqitjen e çdo veprimi juridik apo procedural për mbrojtjen sa më mirë të interesave të tij. Sipas subjektit, e drejta për të caktuar një avokat është një e drejtë procedurale dhe që garanton një mbrojtje më efektive të të drejtave të paditësit për shkak të njohurive të posaçme të avokatit. Në rastin konkret, djali i paditësit mbi bazën e prokurës së dhënë nga babai i tij dhe të tagrit për të kryer çdo veprim që ai e ka çmuar të arsyeshëm për mbrojtjen e interesave të babait të tij ka caktuar avokat, të cilit i ka kaluar të gjithë tagrat sipas prokurës. Në rastin konkret, veprimi i përfaqësuesit për të caktuar avokat është një veprim i dhënë nga vetë pala ankuese në kuadrin e kryerjes së të gjitha veprimeve procedurale dhe ligjore në mbrojtje sa më të mirë të interesave të tij. Në përfundim, mbi kërkesën e avokatit të palës paditëse brenda tagrave të dhënë nëpërmjet prokurës së posaçme për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, është disponuar nga e subjektit me vendim jopërfundimtar për pushimin e gjykimit. Subjekti ka shpjeguar se ky vendim, duke mos qenë përfundimtar, nuk sjell asnjë pasojë për palët, pasi ato kanë të drejtë

që t'i drejtohen në çdo kohë gjykatës, për më tepër që objekti i gjykimit kishte të bënte me një të drejtë të paparashkrueshme që është e drejtë për të përfiturar një nga llojet e pensionit.

Po për këtë çështje, subjekti ka parashtruar se pretendimi i palës ankuese se ky vendim është marrë prej saj me qëllim që t'i kalojnë afatet procedurale, është një pretendim i pabazuar, pasi pala ankuese V.L, pas vendimit të pushimit nr. ***, datë 27.2.2014, i është drejtuar disa herë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të njëjtën padi. Ky fakt provohet me anë të vërtetimit nr. *** prot., datë 28.2.2023. Ky vendim ka marrë formë të prerë më 4.3.2014, që sipas subjektit tregon se vetë pala ankuese V.L ka qenë dakord me vendimin e pushimit, pasi nuk ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

43.2.v Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se ato nuk qëndrojnë, për arsye se përfaqësimi me avokat është një tagër specifik i legjitimuar në nenin 67 të Kodit Civil, ku thuhet shprehimisht: *“Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuari e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij”*.

Në këtë drejtim, trupi gjykues konstaton se referuar përmbajtjes së prokurës së posaçme datë 11.10.2013, nuk përcaktohet nëndelegimi i përfaqësimit sipas nenit 67 të Kodit Civil.

Për sa më sipër, vlerësohet se legjitimiteti i përfaqësuesit është ndër hapat e parë proceduralë që duhet të ndërmerret gjykata, për të vijuar më tej me zhvillimin e procesit ose me kthimin e akteve për plotësim të metash.

Në ndryshim nga pretendimi i subjektit, trupi gjykues vlerëson se konsiderimi ligjor i prokurës nuk është çështje interpretimi, për më tepër kur në rastin konkret pasoja e ardhur nga avokati pa tagër eksplicite nga denoncuesi (si palë paditëse në gjykim) ka qenë pushimi i çështjes. Në përfundim, trupi gjykues këtë çështje e vlerëson si mangësi të subjektit në drejtim të mosveprimit të saj në verifikimin e elementeve ligjore të tagrave të përfaqësimit të palës ndër gjyqëse. Kjo mangësi e konstatuar për një çështje të gjykuar në vitin 2014 mbetet e kufizuar në raport me elementet e tjera pozitive të konstatuara në drejtim të indikatorëve të kriterit profesional, duke e çmuar të pamjaftueshme se mund të cenojë këtë kriter apo procesin e rivlerësimit të saj në tërësi.

43.3 Ky denoncues, lidhur me çështjen e dytë me nr. ***, datë regjistrimi 2.11.2015, e gjykuar përsëri nga subjekti i rivlerësimit, me objekt padie “detyrimin e ZVRPP Tiranë për regjistrimin e një pasurie të paluajtshme sipas vendimit nr. ***, datë 11.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, pretendon për shkelje procedurale referuar ligjit nr. 49/2012, duke parashtruar se: (i) subjekti ka caktuar pjesëmarrjen në seancë gjyqësore të një eksperteje psikologe të palicencuar; (ii) pa përfunduar procesi i shqyrtimit dhe gjykimit të çështjes gjyqësore largoi përfaqësuesen ligjore të palës së paditur pa asnjë arsye.

43.3.i Për sa më lart, Komisioni, lidhur me pretendimet e subjektit, ka administruar kopje të dosjes gjyqësore nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁶⁴.

43.3.ii Nga shqyrtimi dhe analizimi i përmbajtjes së akteve në dosje lidhur me çështjen e dytë gjyqësore me nr. ***, datë regjistrimi 2.11.2015, me objekt “detyrimin e ZVRPP Tiranë për regjistrimin e një pasurie të paluajtshme sipas vendimit nr. ***, datë 11.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, Komisioni nga aktet në dosje konstatoi të administruar raportin e vlerësimit psikologjik për paditësin V.L, përgatitur nga psikologe klinike S.S, lidhur me këtë çështje, e caktuar nga gjykata për t'iu përgjigjur pyetjes nëse paditësi ka pësuar dëm moral apo

⁶⁴Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.1.2023.

cenim dinjiteti si rezultat i cenimit të pasurisë, konkretisht pjesës takuese të pasurisë së trashëguar nga prindërit e tij.

43.3.iii Në lidhje me pretendimin e denoncuesit, i cili pretendon se ekspertja psikologe e caktuar nga gjykata ka qenë e palicencuar, Komisionit nga verifikimi i akteve në dosje i rezultoi se ekspertja S.S, e diplomuar me nr. ***, është caktuar nga gjykata me vendimin përkatës, i pasqyruar edhe në procesverbalin për caktimin e së cilës vetë pala paditëse nuk ka pasur kontestime. Po ashtu, vërehet se në raportin e vlerësimit psikologjik përshkruhen detyrat e lëna nga gjykata për këtë çështje.

43.3.iv Komisioni i kërkoi subjektit të depozitojë kopje të listës së ekspertëve psikologë, për të cilën subjekti ka shpjeguar se në vitin 2015 dhe fillimin e vitit 2016, kur ka përfunduar gjykimi i kësaj çështjeje, profesioni i ekspertëve psikologë nuk ka qenë i rregulluar ligjërisht⁶⁵, si dhe nuk ka pasur një listë të ekspertëve psikologë të miratuar nga Ministria e Drejtësisë apo institucion tjetër shtetëror. Për këtë fakt ka depozituar korrespondencën e mbajtur me Urdhrin e Psikologut, i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

43.3.v Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur më këtë çështje në drejtim të kriterit profesional.

43.3.vi Komisioni ftoi subjektin të qartësonte statusin aktual të vendimmarrjes së saj, duke depozituar dokumentacion mbështetës.

- Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku konfirmohet se vendimi ka mbetur në fuqi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe se nuk është rekursuar.

43.4 Po për këtë çështje të trajtuar në pikën 43.3, nga denoncuesi është pretenduar se subjekti pa përfunduar procesin e shqyrtimit dhe gjykimit të çështjes gjyqësore largoi përfaqësuesen ligjore të palës së paditur pa asnjë arsye.

43.5 Nga aktet e administruara në dosje, si dhe nga dëgjesa në audio, nuk konfirmohet pretendimi i denoncuesit.

44. Denoncim⁶⁶ i shtetasit F.SH

44.1 Denoncuesi ankohet duke pretenduar se ndaj tij subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim në kundërshtim me faktet dhe të gjithë kornizën ligjore, si dhe për faktin se mungesa e aftësive të saj profesionale kanë bërë të mundur favorizimin e palëve të tjera ndërgjyqëse.

44.2 Shtetasi F.SH, së bashku me disa të tjerë, janë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, të llojit “truall”, e ndodhur në z.k. ***, Tiranë dhe njëkohësisht bashkëpronarë të pasurisë me nr. **. Ata pretendojnë se mbi pronat e tyre janë miratuar disa leje legalizimi nga ALUIZNI Tiranë, në kundërshtim flagrant me ligjin. Për këtë arsye, ata kanë depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë një padi me objekt “konstatimin absolutisht të pavlefshëm të disa lejeve të legalizimit të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tiranë” etj.

44.3 Pas shqyrtimit të kësaj padie, gjykata, me vendimin nr. ***, datë 26.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesëpadie si të pabazuar në ligj dhe në prova. Komisioni nga vendimi gjyqësor bashkëlidhur këtij denoncimi konstatoi se ky vendim është marrë nga trupi gjyqësor, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues.

⁶⁵Urdhri i Psikologëve të Republikës së Shqipërisë, i cili më ka informuar se profesioni i ekspertit psikolog është rregulluar me anë të ligjit nr. 40/2016, “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 24.5.2016.

⁶⁶Nr. *** prot., datë 5.12.2018.

44.4 Për sa është konstatuar më lart, Komisioni i kërkoi⁶⁷ subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me statusin ligjor të kësaj çështjeje gjyqësore, duke depozituar edhe dokumentacion ligjor provues.

44.5 Subjekti⁶⁸ i rivlerësimit lidhur me statusin ligjor të vendimit nr. ***, datë 26.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, të dhënë prej saj, ka sqaruar se ndaj vendimit është ushtruar ankim nga pala paditëse dhe në datën 20.12.2018 është dërguar dosja gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe deri në datën e kthimit të kësaj përgjigjeje dosja nuk është kthyer ende. Subjekti, në mbështetje të shpjegimit të dhënë, depozitoi pranë Komisionit si dokumentacion provues: (i) kopje të vendimit nr. ***, datë 26.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë; si dhe (ii) fletën e regjistrimit të dërgimit të dosjeve pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

44.6 Nisur nga sa u konstatua më sipër, Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë kryesisht me themelin e çështjes dhe vendimmarrjen, elemente dhe akte të cilat janë objekt ankimi në gjykatën më të lartë. Në të tilla kushte, nuk u konstatuan problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional apo etik të subjektit.

45. Denoncim⁶⁹ i shtetasit K.Z (bashkim i dy denoncimeve)

45.1 Denoncuesi ankohet për një grup subjektsh në tërësi në sistemin e drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë policie gjyqësore, duke i cilësuar si një grup të strukturuar kriminal. Ky denoncim është administruar pranë Komisionit në mënyrë të përsëritur, një herë si denoncim nga vetë shtetasi K.Z dhe një herë tjetër po i njëjti denoncim, i përcjellë nëpërmjet Komisionerit Publik.

45.2 Denoncuesi në pretendimin e tij kërkon nga Komisioni që të hetojë lidhur me veprimet antiligjore të disa prokurorëve që kanë ndjekur dhe përfunduar veprimet hetimore lidhur me procedimin penal të regjistruar në emrin e tij, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetases F.N, dyshuar për veprat penale që u përkasin neneve 186/a dhe 121/a të Kodit Penal.

45.3 Komisioni nga aktet ligjore bashkëlidhur denoncimit vëren se në kuadër të këtij kallëzimi denoncuesi është arrestuar dhe dënuar me masën e sigurimit “arrest me burg” me vendimin nr. ***, datë 30.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.

45.4 Ndër subjektet e përmendura në këtë denoncim përmendet edhe subjekti i rivlerësimit Gentiana Muçaj, pasi kjo shtetase në vijim të proceseve të tjera gjyqësore i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padi me objekt “shpërbllim dëmi jopasuror”, gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

45.5 Referuar vendimit gjyqësor nr. ***, datë 25.5.2017, të ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se ajo ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse, K.Z, si të pabazuar në prova dhe në ligj. Nga shpjegimet e denoncuesit në ankesë rezultoi se ky vendim gjyqësor është ankimuar dhe ndodhet për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

45.6 Për sa është konstatuar më lart, Komisioni⁷⁰ i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me statusin ligjor për këtë çështje gjyqësore, duke depozituar edhe dokumentacion ligjor provues.

⁶⁷Pyetësor nr. 4, dërguar subjektit me *email* në datën 5.1.2023.

⁶⁸Kthim përgjigjeje pyetësorit nr. 4 me nr. *** prot., datë 11.1.2023.

⁶⁹Nr. *** prot., datë 26.2.2019, denoncim nr. *** prot., datë 7.3.2019.

⁷⁰Pyetësor nr. 4, dërguar subjektit me *email* në datën 5.1.2023.

45.7 Subjekti⁷¹ i rivlerësimit, lidhur me statusin ligjor të vendimit nr. ***, datë 25.5.2017, ka sqaruar se ndaj saj është ushtruar ankim nga pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 4.4.2019, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 25.5.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është bërë rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Më tej, nga shpjegimet e subjektit rezulton se dosja gjyqësore është nisur në Gjykatën e Lartë në datën 20.6.2019 dhe deri në ditën e kthimit të kësaj përgjigjeje nuk është kthyer ende. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, ka depozituar si dokumentacion provues: (i) shkresën⁷² e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; (ii) kopje të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 25.5.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; si dhe (iii) fletë të regjistrimit.

45.8 Për sa më sipër, Komisioni nga verifikimi i akteve bashkëlidhur denoncimit, në raport me pretendimet e denoncuesit, vërejtë se dukej që ato lidheshin kryesisht me themelin e çështjes, për zgjidhjen e së cilës ka kompetencë gjykata më e lartë. Në të tilla kushte, nuk u konstatuan problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional apo etik të subjektit.

46. Denoncim⁷³ i shtetasit RR.U

46.1 Denoncuesi në këtë denoncim ankohet se ndaj tij subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim gjyqësor në keqdashje dhe interpretim të gabuar të ligjeve materiale.

46.2 Komisioni, referuar akteve bashkëlidhur këtij denoncimi, vëren se AKU Tiranë në datën 15.10.2018 ka vendosur ndaj shtetasit RR.U një gjobë në shumën 300.000 lekë dhe, për këtë arsye, ky shtetas ka depozituar një kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “kundërshtimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv/kundërshtimin e veprimeve përmbarimore dhe detyrimin e AKU Tiranë të shfuqizojë gjobën e vendosur padrejtësisht”.

46.3 Për çështjen më sipër, me nr. ***, datë 9.7.2019, ai pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim në kundërshtim me provat shkresore të analizuara, të dokumentuara në seancat gjyqësore dhe ligjin material. Gjithashtu, ai pretendon se gjoba nuk mund të kthehej në titull ekzekutiv pa u shteruar ankesat administrative, pasi kishte depozituar më parë pranë AKU-së Tiranë 4 ankesa, duke kundërshtuar vendosjen në mënyrë të padrejtë të gjobës.

46.4 Lidhur me këtë denoncim, pranë Komisionit është administruar shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila informon Komisionin se pas verifikimeve të kryera në Zyrën e Regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se nga data 1.1.2006 e deri më sot është regjistruar materiali hetimor nr. *** ndaj subjektit të rivlerësimit Gentiana Muçaj, për të cilën është marrë vendimi i mosfillimit në datën 12.8.2019.

46.5 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime bindëse lidhur me pretendimin e denoncuesit, si dhe të qartësojë lidhur me statusin ligjor të kësaj çështjeje, duke depozituar edhe dokumentacion provues.

46.6 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se pala ankuese/paditëse RR.U gjatë gjykimit: (i) nuk ka qenë i qartë në pretendimet e tij përpara gjykatës; (ii) pretendonte kundërshtimin e veprimeve përmbarimore në tërësi pa specifikuar veprimin konkret përmbarimor që ai kundërshtonte; (iii) pretendonte se aktet administrative të mbajtura nga pala e tretë, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë, janë të falsifikuara, të dala në mashtrim të ligjit, si dhe në konflikt interesi.

⁷¹Kthim përgjigjeje pyetësorit nr. 4 me nr. *** prot., datë 11.1.2023.

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 6.1.2023, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁷³Nr. *** prot., datë 15.7.2019.

Subjekti ka pasqyruar referenca ligjore se ku është bazuar për gjykimin e drejtë të çështjes. Subjekti ka sqaruar se, pavarësisht kërkesave të ndryshme të denoncuesit gjatë procesit gjyqësor, gjykata ka vlerësuar t'i argumentojë ato.

Subjekti ka referuar nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, i cili bën një mbrojtje të subjekteve të marrëdhënies juridike procedurale, nga veprimet ose mosveprimet e përmbartuesit gjyqësor në kundërshtim me ligjin procedural, duke qartësuar se në referencë të këtij neni, si dhe rastit konkret, gjykata nëpërmjet vendimit të saj ka konkluduar se veprimet e përmbartuesit gjyqësor privat I.T, të kryera për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, nuk rezultojnë të jenë në kundërshtim me ndonjë dispozitë procedurale. Subjekti ka vijuar të sqarojë se në këndvështrim të nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, nga pala paditëse (pra, nga denoncuesi në këtë rast) nuk u provua gjatë gjykimit paligjshmëria e veprimeve të përmbartuesit gjyqësor dhe, për pasojë, ky pretendim i palës ankuese/paditëse RR.U është rrëzuar nga gjykata si një pretendim i pabazuar në ligj dhe në prova.

Subjekti ka qartësuar në lidhje me statusin e gjykimit të kësaj çështjeje, duke konfirmuar se çështja rezulton e dërguar për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Subjekti ka depozituar edhe shkresën⁷⁴ përkatëse në mbështetje të këtij deklarimi.

46.7 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, konstaton se subjekti ka shpjeguar në mënyrë shteruese çështjen objekt i këtij hetimi administrativ, në referencë edhe të bazës ligjore ku është mbështetur, ka dhënë mjaftueshëm argumente mbi vendimmarrjen e saj. Ndërkohë, konfirmohet se çështja është ankimuar dhe vijon të jetë në gjykatat më të larta, të cilat kanë kompetencë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimmarrjes.

46.8 Në të tilla kushte, duket se nuk vërehen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

47. Denoncim⁷⁵ anonim nga një grup juristësh, të cilët përfaqësojnë palën shtet në gjykimet administrative (dorëzuar nga B.K)

47.1 Ky denoncim i administruar pranë Komisionit është bërë nga një grup juristësh, të cilët përfaqësojnë palën shtet në gjykimet administrative. Denoncimi përfshin shumë subjekte rivlerësimi, nëpërmjet të cilit pretendohet për veprime të jashtëligjshme dhe veprimtari korruptive në sistemin e drejtësisë. Ata denoncojnë një grup subjektësh rivlerësimi, ku ndër ta edhe gjyqtaren Gentiana Muçaj, për të cilën pretendojnë se me vendimin gjyqësor të datës 31.1.2017, gjyqtarja F.P me anëtarin A.M dhe gjyqtaren e Shkallës së Parë, që kishte gjykuar këtë çështje, shoqen e tyre të klasës në magistraturë Gentiana Muçaj (e cila ka mundësuar negociim për ndryshimin e vendimit), kanë vendosur haptazi në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, ata pretendojnë se kjo gjyqtare në përgjithësi i rrëzon paditë me palë shtetin dhe i pranon këto padi në mënyrë abuzive në kundërshtim me ligjin vetëm kur ka pasur ndërhyrje nga subjekte të tjera.

47.2 Për sa më lart, Komisioni ka konstatuar se ky denoncim në përmbajtjen e tij ka natyrë të përgjithshme dhe nuk mbështetet në prova dhe rrethana nga të cilat të përcaktohen shkelje konkrete për subjektin e rivlerësimit.

48. Denoncim⁷⁶ i shtetasit Z.O

48.1 Shtetasit Z dhe K.O, të përfaqësuar me prokurë nga av. XH.H, ankohen lidhur me çështjen gjyqësore me nr. vendimi ***, datë 22.12.2020, me objekt “kundërshtimin dhe ndryshimin e pjesëshëm të aktit administrativ VKM nr. 231, datë 17.4.2019” për sa i përket vlerës së

⁷⁴Nr. *** prot., datë 27.2.2023, të zëvendëskryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁷⁵Nr. *** prot., datë 9.7.2020.

⁷⁶Me kërkesën nr. *** prot., datë 12.1.2021.

shpronësimit të pasurisë së paluajtshme e llojit “ndërtesë”, regjistruar me nr. pasurie ***. Nëpërmjet kësaj ankese ata kërkojnë nga Komisioni marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi kjo e fundit ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova lidhur me çështjen e përshkruar më sipër.

48.2 Komisioni, nga verifikimi i vendimit gjyqësor bashkëlidhur denoncimit, vëren se subjekti në vendimmarrje, pasi ka analizuar në tërësi çështjen, aktet shkresore të paraqitura me cilësinë e provës nga palët ndërgjyqëse dhe atyre të administruara gjatë gjykimit, ka çmuar dhe vendosur rrëzimin e kësaj kërkesëpadie, duke argumentuar, ndër të tjera, se: (i) nga provat shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe të administruara në seancë gjyqësore, procedura për shpronësimin e pronarëve që preken nga zbatimi i projektit është në përputhje të plotë me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet për interes publik”; (ii) nuk kemi të bëjmë me përcaktime arbitrare të vlerës së pronës, por me caktimin e kësaj vlere në bazë të një metodike dhe procedure të përcaktuar në mënyrë të qartë në aktet ligjore referuar nenit 3 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999; (iii) lidhur me vlerën e shpronësimit në pjesën arsyetuese të vendimit, subjekti referon edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, konkretisht, neni 1 i protokollit 1 të KEDNJ-së nuk garanton një të drejtë për kompensim të plotë; (iv) shpronësimi për interes publik dhe vlera për kompensim është bërë duke u bazuar në zërin kadastral të pasurisë së paluajtshme objekt shpronësimi.

48.3 Komisioni nga shqyrtimi i vendimit gjyqësor konstatoi se ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

48.4 Për sa më lart, Komisioni për këtë çështje gjyqësore i kërkoi subjektit⁷⁷ të japë shpjegime lidhur me statusin ligjor të saj, duke depozituar edhe dokumentacion provues.

48.5 Subjekti⁷⁸ i rivlerësimit, lidhur me statusin ligjor të vendimit nr. ***, datë 22.12.2020, ka sqaruar se ky vendim është ankimuar nga pala paditëse dhe dosja gjyqësore në datën 4.2.2021 është dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ILD-ja me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2021, ka bërë me dije atë/subjektin se pas shqyrtimit fillestar të ankesës së bërë nga shtetasit Z dhe K.O për këtë çështje, me vendimin nr. *** prot, datë 12.4.2021, ka vendosur arkivimin e saj. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit si dokumentacion provues: (i) kopje të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 22.12.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; (ii) fletë të regjistrit të dërgimit të dosjeve pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; (iii) shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2021, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me lëndë “njoftimin mbi arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar”; si dhe (iv) vendimin nr. *** prot., datë 12.4.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

48.6 Për sa është shpjeguar më lart, Komisioni konstatoi se pretendimet e denoncuesit për këtë çështje lidhen me themelin e saj, e cila është objekt ankimi në gjykatën më të lartë. Në të tilla kushte, duket se nuk u konstatuan problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

49. Trupi gjykues, pas analizimit të denoncimeve të depozituara, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe shpjegimeve të subjektit bazuar në legjislacion, vlerëson se në tërësi nuk konstatohen problematika që ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit në aspektin e saj profesional.

⁷⁷Pyetësor nr. 4, datë 5.1.2023, dërguar subjektit me *email*.

⁷⁸Kthim përgjigjeje pyetësorit nr. 4, depozituar pranë Komisionit, nr. *** prot., datë 11.1.2023.

50. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale⁷⁹, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konstaton se gjatë vlerësimit të aftësive etiko-profesionale ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan elemente që ta identifikonin atë me të meta apo probleme në gjykimin e rasteve të tjera individuale, të tilla si mosrespektim i afateve ligjore, referenca të gabuara ligjore, dosje të paplota apo të tjera në drejtim të cenimit të indikatorëve vlerësues sipas ligjit nr. 76/2016.

50.1 Në këtë drejtim, mangësitë e evidentuara në vendimin gjyqësor të subjektit të rivlerësimit, nr. ***, datë 21.7.2016, trupi gjykues i vlerëson të pamjaftueshme për t'i çmuar si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e saj apo për ta identifikuar si një magjistrate, e cila ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e saj.

50.2 Sa më sipër, trupi gjykues çmoi që mangësitë e konstatuara në çështjen e sipërcituar mund të vlerësohen nga organi kompetent ILD sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, duke e transferuar pranë tij për inspektim të mëtejshëm.

51. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas propozimit të relatores së çështjes, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “e aftë”.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁷⁹Referuar nenit E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ”. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale [shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias]; nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentiana Muçaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Transferimin e çështjes që i korrespondon vendimit gjyqësor të subjektit të rivlerësimit, nr. ***, datë 21.7.2016, pranë organit kompetent, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 9.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka